



Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2014



Parathënie

Viti i shtatë i aktivitetit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut tashmë ka kaluar. Gjatë vitit 2014, Paneli ka dhënë një numër mendimesh në lëndët me ankesa të personave, të cilët pretendonin për shkelje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u gjatë periudhës të administrimit të vet ekzekutiv. Në pjesën më të madhe të këtyre lëndëve, ankuesit pohonin për mungesë të hetimeve adekuate penale, në lidhje me zhdukjet, rrëmbimet dhe vrasjet, në pajtim me obligimet procedurale që dalin sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa i përket trajtimit jonjerëzor dhe degradues të anëtarëve të familjes dhe të afërmve tjerë të ngushtë të viktimave. Në mendimet e veta, Paneli zgjeroi dhe konsolidoi praktikën e vet gjyqësore tashmë gjithëpërfshirëse në këto fusha, veçanërisht për sa u përket çështjeve të reja specifike që dolën në disa nga këto lëndë.

Përveç kësaj, pas shqyrtimit të më shumë se 100 ankesave, në të cilat pretendohet për mungesën e hetimeve adekuate penale në lidhje me zhdukjet, rrëmbimet dhe vrasjet, Paneli paraqet me të dhëna se dështimet e UNMIK-ut ishin sistemore në këtë drejtim dhe nuk mund të arsyetoheshin në dritë të vështirësive që UNMIK-u i hasi në fillim të misionit të vet.

Paneli, po ashtu, dha mendime në dy raste diskriminimi, duke konstatuar se ankuesit ishin diskriminuar në procedurat para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për shkak të etnisë së tyre minoritare, në shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së.

Ekipi i vogël, megjithëse shumë i kualifikuar dhe i përkushtuar i Sekretariatit të Panelit, i ndihmoi shumë Panelit në përgatitjen e një numri të madh të mendimeve cilësore në vitin 2014.

Në përgjithësi, bashkëpunimi i Panelit me UNMIK-un në rastet në zhvillim e sipër ka vazhduar si në vitet e kaluara. Një problem i madh strukturor megjithatë mbetet, për të qenë më specifik implementimi i mendimeve të Panelit, veçanërisht për sa i përket kërkim faljeve kuptimplota dhe kompensimit financiar për ankuesit. Mu sikur në raportet paraprake, ai e përsërit se OKB-ja vazhdon të mohojë çdo lloj kompensimi financiar në rastet ku Paneli e ka konstatuar se UNMIK-u ka bërë shkelje të të drejtave të njeriut. Asgjë nuk ka ndryshuar në këtë drejtim që nga raporti i mëparshëm vjetor i Panelit.

Mbetet shpresa se EULEX-i dhe institucionet e Kosovës për zbatimin e ligjit do të jenë aktive dhe efikase në veçanti në vazhdimin e hetimeve në rastet e lidhura me rrëmbimet, zhdukjet dhe vrasjet në të cilat Paneli ka konstatuar mangësi substanciale, megjithëse deri më tani ka pak dëshmi të ofruara se po bëhet diçka e tillë.

Viti 2014 ishte gjithashtu një periudhë e diskutimit dhe reflektimit në kuadër të Panelit dhe Sekretariatit lidhur me çështje të ndryshme që ndërlidhen me lëvizjen drejt përfundimit të mandatit të tij dhe përgatitjes së raportit final, i cili do të paraqesë trashëgiminë e Panelit. Përvoja e fituar që nga fillimi i aktivitetit të tij duhet konsideruar se paraqet një kontribut të rëndësishëm për debatin mbi mekanizmat për mbrojtje ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht në

lidhje me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe përgjegjësinë e tyre për të drejtat e njeriut.

Marek Nowicki

kryesues

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

mars 2015

Përmbajtja

1. Hyrje	1
2. Përbërja e Panelit	2
2.1. Anëtarët e Panelit	2
2.2. Stafi i Sekretariatit	4
3. Mbulimi i aktivitetit të PKDNJ-së nga mediet dhe OJQ-të	6
4. Ngarkesa me lëndë e Panelit	7
4.1. Statistikat	7
4.2. Mendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës	7
5. Rastet e papërfunduara si më 31 dhjetor 2014	8
6. Jurisprudenca e Panelit	9
6.1. Çështjet e bazueshmërisë	9
6.1.1. E drejta në jetë– e drejta për hetim efektiv- neni 2 i KEDNJ-së	9
6.1.2. Mosdiskriminimi- neni 14 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së	15
7. Rekomandimet e Panelit	17
8. Reagimet e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit	19
8.1. Vazhdimi i hetimeve .	19
8.2. Kërkim faljet publike	19
8.3. Kompensimi	20
9. Përfundime	22
10. Lista e shtojcave	23
Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12	24
Shtojca B: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2009/1	31
Shtojca C: Tabela statistikore e PKDNJ-së	34
Shtojca D: Lista e vendimeve dhe mendimeve të PKDNJ-së të marra në vitin 2014	35
Shtojca E: Vendimet dhe mendimet e miratuara sipas vitit	38
Shtojca F: Rastet e mbyllura të PKDNJ-së (të papranueshme, të hedhura poshtë dhe mendimi mbi bazueshmërinë) sipas vitit	38
Shtojca G: Shkurtesat dhe akronimet	39

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të 23 marsit të vitit 2006,¹ vazhdoi t'i shqyrtojë ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut të kryera nga Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), apo që i atribuohen atij, gjatë vitit të shtatë të funksionimit të tij të plotë (2007-2014) në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizmi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut, që pretendohet se janë kryer nga Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij. Edhe pse Paneli nuk mund të urdhërojë kompensim apo ndihmë specifike, Paneli mund të vendosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe, nëse ky është rasti, ai mund t'i japë rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me kompensimin dhe ndihmën tjetër specifike.
2. Me gjithë mungesat e mëdha të stafit në Sekretariat për gjysmë viti, Paneli arriti të ketë një periudhë shumë të suksesshme të shqyrtimit të ankesave. Prandaj, në vitin 2014, Paneli miratoi më shumë mendime substanciale sesa në ndonjë vit paraprak. Ky raport vjetor përfshin periudhën 1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2014, gjatë së cilës kohë Paneli mbajti 11 seanca, duke përfshirë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike. Gjatë këtij viti, Paneli miratoi 56 mendime mbi bazueshmërinë (në lidhje me 96 ankesa), gjeti 2 ankesa tjera si pjesërisht të pranueshme, 1 ankesë e shpalli të papranueshme dhe 4 kërkesa i hodhi poshtë për rishikim të vendimeve të mëparshme. Nga gjithsej 527 ankesa të regjistruara, disa nga të cilat përfshijnë një numër të madh të ankuesve të përmendur me emër, deri në fund të vitit 2014 janë përfunduar gjithsej 439 ankesa, ndërsa pjesa e mbetur prej 88 ankesave janë në zhvillim e sipër në faza të ndryshme të procedurave. Përveç kësaj, Paneli vazhdoi punën e vet të rregullt në të gjitha rastet në zhvillim e sipër. Paneli pret ta përfundojë punën e vet në vitin 2015.
3. Në vitin 2014, anëtarët e Panelit u takuan me një delegacion të Grupit Punues të OKB-së për zhdukjet e imponuara dhe të pavullnetshme. Përveç kësaj në vitin 2014, anëtarët e Panelit dhe Sekretariati mbajtën lidhje me Panelin për Shqyrtim të të Drejtave të Njeriut të EULEX-it dhe diskutuan çështjet me interes të dyanshëm.
4. Për të përsosur më tutje ekspertizën e vet në lëndët në kuadër të kompetencës së Panelit, juristët e Sekretariatit vizituan Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës, ku ata krijuan lidhje me juristët nga Zyra e Sekretarisë e Gjykatës, të cilët specializohen në rastet që kanë të bëjnë me personat e zhdukur dhe/apo të vrarë apo në rastet e tjera që përkrijnë me lëndën në ankesat e dorëzuara Panelit. Këto takime u dëshmuuan të jenë jashtëzakonisht produktive për Sekretariatin pasi në informatat e shkëmbyera në mes juristëve u theksua natyra e përputhshme e jurisprudencës së të dy institucioneve.
5. Në vitin 2014, Paneli dhe Sekretariati vazhduan me përdorimin e gjerë të burimeve të tjera për të mbledhur informata, të cilat nuk ishin në gjendje t'i mbledhin nga ankuesit apo parashtrësat e PSSP-së për Panelin. Për shembull, Panelit iu ofruan informata

¹Bashkëngjitur si shtojca A.

jashtëzakonisht të dobishme, duke përfshirë dokumente relevante hetimore që kanë qenë para kësaj të paarrtshme, nga Zyra e Prokurorisë Speciale në Kosovë, kryeprokurori nga Prokuroria Themelore në Prizren, Policia e UNMIK-ut dhe Policia e Kosovës. Informatat e marra iu komunikuan të gjitha palëve në ankesat para Panelit.

6. Sekretariati gjithashtu vuri kontakt me ankuesit individualë, si dhe organizatat që kanë lidhje me rastet, siç janë Shoqata e Familjeve të të Rrëmbyerve dhe Vrarëve në Kosovë dhe Metohi, dhe gjithashtu zyrtarët e programit “Përkrahje për implementimin e strategjive për PZHB-të, refugjatët dhe të kthyerit– Ndhima ligjore”, për të mbledhur informata relevante kur kërkohet. Përveç kësaj, Sekretariati rregullisht u mbështet në informatat e publikuara në bazat e të dhënave ‘online’ të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK)² dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (KNPZH)³, dhe gjithashtu informatat e përmendura nga Qendra për të Drejtën Humanitare.⁴

2. Përbërja e Panelit

2.1. Anëtarët e Panelit

7. Tre anëtarët e Panelit, të emëruar nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të (ri)emëruar nga PSSP-ja në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, të 1 janarit të vitit 2014, ishin z. Marek Nowicki (Poloni), znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi) dhe znj. Françoise Tulkens (Belgjikë)⁵. Paneli e zgjodhi z. Marek Nowicki si kryesues të tij në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë si kryesues në vitin 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014⁶.
8. Informatat për biografinë e anëtarëve të Panelit janë dhënë më poshtë.
9. **Marek A. Nowicki** (janar 2007- aktualisht) shtetas polak, avokat i të drejtave të njeriut dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës që nga viti 1987.
10. Z. Nowicki ishte Ombudsperson ndërkombëtar në Kosovë i emëruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, prej korrikut të vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Ai ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, nga marsi i vitit 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe ishte anëtar nga Polonia i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore nga marsi i vitit 2003 deri në shtator të vitit 2006. Më 2005 ai u emërua nga Komisioni i Ministrave si njëri prej tre kandidatëve për postin e Komisarit për të Drejta të Njeriut të Këshillit të Evropës.

² Lista e KNKK-së është në dispozicion në <http://familylinks.icrc.org/kosovo/en/pages/search-persons.aspx>

³Baza e të dhënave e KNPZH-së është në dispozicion në: http://www.icmp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en

⁴ Shih: *Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë. 24 mars 1999 – 31 dhjetor 2000*, f. 12 // faqja e internetit e QDH-së [burimi elektronik] - <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/02/KO-Abductions-and-disappearances-of-non-Albanians-in-Kosovo-1.pdf> (e qasur më 20 mars 2015)

⁵ Emërimi dhe riemërimi i znj. Tulkens nga PSSP-ja përfshinë periudhën e njëjtë por ishte në fuqi prej 14 shtatorit të vitit 2012 deri më 13 shtator të vitit 2013, 14 shtatorit të vitit 2013 deri më 13 shtator të vitit 2014 dhe 14 shtator të vitit 2014 deri më 13 shtator të vitit 2015.

⁶ Shih: Rregullorja e punës e PKDNJ-së, rregulla 6.

11. Z. Nowicki ishte njëri nga “juristët eminentë” të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe Azerbajxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i kërkoi atij të shërbejë si ekspert për të drejtat e njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemeve ligjore të Gjeorgjisë dhe Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai shërbeu si ekspert për të drejtat e njeriut i Komisionit Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe në Drejtorinë e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore të Këshillit të Evropës.
12. Z. Nowicki ishte anëtar themelues i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit të vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2008. Aktualisht ai e kryeson Këshillin e Fondacionit. Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe qindra artikujve mbi të drejtat e njeriut, të publikuara në Poloni dhe në vendet e tjera. Ai gjithashtu jep ligjërata për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Institutin Nacional për Administrim Publik në Varshavë. Ai është anëtar i Komisionit përzgjedhës të Çmimit Vaclav Havel për të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.
13. **Christine Chinkin** (shkurt 2010- aktualisht) me shtetësi të dyfishtë britanike/australiane, anëtare e Akademisë Britanike, është aktualisht profesoreshë e së Drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës dhe drejtoreshë e Qendrës për Gra, Paqe dhe Siguri në FEL, të krijuar rishtas. Ajo është po ashtu profesoreshë e së Drejtës globale në Fakultetin e Drejtësisë William C. Cook të Universitetit të Miçigenit. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Jelit dhe Sidnejit dhe ka mbajtur më parë poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oksfordit, Londrës, Sidnejit dhe Sauthamptonit, në Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.
14. Interesimet kryesore të znj. Chinkin janë E drejta ndërkombëtare publike, veçanërisht e drejta për traktatet, të drejtat e njeriut, me theks në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave dhe organizatat ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e konflikteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve mbi çështjet që ndërlidhen me të Drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtat njerëzore të grave, ligjet e Halsburit në Australi, Edrejta në marrëdhëniet me jashtë (edicioni i 2-të 2001), Palët e treta në të drejtën ndërkombëtare (1993), bashkautore e Zgjidhja e konfliktit në Australi (edicioni i 2-të 2002), bashkautore e Kufijtë e të drejtës ndërkombëtare: Një analizë feministe (2000) dhe bashkautore e Krijimit të së drejtës ndërkombëtare (2007), bashkëredaktore e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (2012) dhe Sovraniteti, Shtetësia dhe përgjegjësia e Shtetit (2015). Nga viti 2004-2012, ajo ishte drejtoreshë e studimeve në Asociacionin Ndërkombëtar për të Drejtën. Ajo është anëtare e Institutit të IBA-s për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në prill të vitit 2001 asaj iu nda Certifikata për meritë, e Asociacionit Amerikan për të Drejtën Ndërkombëtare për ‘kontribut të jashtëzakonshëm për diturinë’ dhe në vitin 2006 Medalja e Asociacionit Goler T. Butcher për ‘kontribute të jashtëzakonshme për zhvillimin apo realizimin efektiv të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut’ (me H. Charlesworth).

15. Znj. Chinkin ka qenë konsulente për të drejtën ndërkombëtare e Bankës Aziatike për Zhvillim; për trafikim të grave në Zyrën e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB-së si dhe për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjimore në Divizionin e OKB-së për Avancimin e Grave dhe UNIFEM. Ajo ishte eksperte shkencore në një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të vitit 2011. Ajo ishte anëtare e misionit faktmbledhës në Beit Hanoun në pajtim me Rezolutën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008 dhe misionit faktmbledhës të OKB-së në konfliktin e Gazës në vitin 2009, si dhe misionit faktmbledhës të Këshillit për DNJ të IBA-s përkitazi me sundimin e ligjit në Malavi, në janar të vitit 2012.
16. **Françoise Tulkens** (shtator 2012- aktualisht), shtetasee Belgjikës, ka një doktoratë në drejtësi, magistraturë në penologji dhe ka diplomuar për mësimdhënie në arsim të lartë (*agrégation de l'enseignement supérieur*) në fushën e drejtësisë.
17. Ajo ishte hulumtuuese në Institutin Max Planck për të Drejtën ndërkombëtare dhe të jashtme penale (Freiburg-im-Breisgau, Gjermani). Ajo ishte profesoreshë në Universitetin Louvain (Belgjikë) dhe ka dhënë mësim në Belgjikë dhe gjithashtu jashtë vendit – si profesoreshë vizitore e Universitetit të Gjenevës, Montrealit, Otavës, Parisit I, Renes, Strasburgut dhe Universitetit Shtetëror të Luizianës – në fushën e së Drejtës penale (pjesa e përgjithshme), Edrejta krahasuese dhe penale evropiane, Edrejta e të miturve dhe sistemet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
18. Nga nëntori i vitit 1998 deri në shtator të vitit 2012, ajo ishte gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shërbyer si kryetare e sektorit nga janari i vitit 2007 dhe si nënkryetare e Gjykatës nga shkurti i vitit 2011.
19. Znj. Tulkens është autore e shumë publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale, si dhe bashkautore e librave për referim si: *Introduction au droit penal. Aspects juridiques et criminologiques* (edicioni i 9^{të}, 2010) dhe *Droit de la Jeunesse : Aide, Assistance et Protection* (2000). Ajo gjithashtu bashkëredakton: *Code de droit international humanitaire* (edicioni i 6^{të}, 2013), *Kodi i të Drejtës ndërkombëtare humanitare* (edicioni i 1^{rë}, 2013) dhe *Code de droit international des droits de l'homme* (edicioni i 5^{të}, 2014). Ajo është anëtare e bordeve editoriale të një numri revistash shkencore, në mes tjerash *Revue trimestrielle des droits de l'homme*, *Revista mbi drejtësinë ndërkombëtare penale* dhe *Revista ndëramerikane dhe evropiane për të drejtat e njeriut*.
20. Në vitin 2013 ajo është emëruar si anëtare e Komisionit Shkencor të Agjencisë për të Drejta Themelore (ADTH) të Bashkimit Evropian. Ajo është anëtare e Komisionit Shkencor të Institutit për të Drejtat e Njeriut të Odës së Avokatëve të Brukselit dhe Bordit të Drejtorëve të Akademisë për të Drejtën Evropiane.
21. Ajo mban doktorata nderi nga universitetet e Gjenevës, Limozhit, Otavës dhe Gentit. Ajo është anëtare me korrespondencë e Akademisë Mbretërore të Belgjikës për Shkencë, Letërsi dhe Arte, që nga viti 2011.

22. Znj. Tulkens aktualisht është kryetare e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Mbreti Baudouin.

2.2. Staf i Sekretariatit

23. Staf i Sekretariatit përbëhet nga një zyrtar ekzekutiv, tre zyrtarë ligjorë dhe dy asistente administrative.
24. **Andrey Antonov**, shtetas rus, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2011 si zyrtar ekzekutiv. Më herët z. Antonov punoi si hetues në Divizionin për hetime të Zyrës për Kontroll të Brendshëm në selinë e OKB-së (2011), si zyrtar për disiplinë dhe sjellje në misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sudan (2009-2011), si këshilltar ligjor në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2008-2009), si zyrtar ligjor në Divizionin penal të Departamentit të Drejtësisë (DD) të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (2005-2008), dhe si zyrtar ligjor në Sektorin për Integritet Gjyqësor të DD-së së UNMIK-ut (2003-2005). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, z. Antonov shërbeu në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Rusisë (MPB), si hetues penal në Departamentin për transport të policisë (Anapa, 1996), dhe ligjërues i lartë mbi procedurën penale dhe hetimin penal (Universiteti i Krasnodarit, MPB e Rusisë, 1999-2003). Ai arriti së pari në Kosovë në vitin 2000 si pjesëtar i kontingjentit rus të policisë, i dërguar nga MPB-ja ruse për të shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, ku punoi si zyrtar ligjor në Zyrën ligjore të Komisarit të Policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2002. Z. Antonov mban gradën e doktoratës në drejtësi (PhD), i specializuar në procedurën penale, hetimin penal dhe zbulimin e krimit nga Akademia Ligjore e Volgogradit e MPB-së ruse dhe një magjistraturë në drejtësi (LLM) nga i njëjti institucion. Ai është gjithashtu autor i më shumë se 30 publikimeve në periodikët rusë në lidhje me aspekte të ndryshme të hetimeve penale.
25. **Anna Maria Cesano**, shtetase italiane, iu bashkua Sekretariatit si zyrtare ligjore në maj të vitit 2011. Më herët, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundim të ligjit në Programin për qasje në drejtësi të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2010-2011), si zyrtare për ndërlidhje në Zyrën e Komisarit për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Tanzani (2009) dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2007-2009). Para se t'i bashkohej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, znj. Cesano punoi në Universitetin e Sienës, Itali (2006-2007) si hulumtuuese mbi sistemin evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Znj. Cesano filloi punën për herë të parë në Ballkan në vitin 2005 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, në Serbi dhe Mal të Zi. Ajo ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin e Pizës për studime të avancuara Sant' Anna dhe mban një magjistraturë në drejtësi nga Universiteti Katolik i Milanos, Itali.
26. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish-anëtar i Odës së Avokatëve të Pensilvanisë, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në tetor të vitit 2011. Më herët, z. Gardner shërbeu si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në emër të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (2009-2011).

Para kësaj, z. Gardner shërbeu si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse për sundim të ligjit të UNMIK-ut (2007-2009). Z. Gardner gjithashtu ka ushtruar detyrën e avokatit në Pensilvani (2006-2007). Z. Gardner ka doktoruar në drejtësi në Universitetin e Pitsburgut si dhe ka diplomuar në shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.

27. **R. Dule Vicovac**, një shtetas kanadez dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Manitobas në Kanada dhe Odës së Avokatëve të Minesotës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në gusht të vitit 2014. Më herët z. Vicovac punoi si avokat në rastet penale dhe të refugjatëve në Kanada (2013-2014) pasi i kaloi mbi 12 vjet në ish-Jugosllavi. Ai po ashtu punoi si ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja për ndihmë ligjore nëpërmjet të cilit ndihmoheshin personat të zhvendosur nga Kosova (2011-2012), si udhëheqës ekipi/ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut & Minoritetet të Serbisë (2010-2011) dhe si ekspert ligjor në Këshillin Danez për Refugjatë për t'iu ndihmuar personave të zhvendosur në ish-Jugosllavi (2008-2009). Para kësaj z. Vicovac shërbeu si zyrtar ligjor në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut si ushtrues detyre i sekretarit në Divizionin për Përkrahje Ndërkombëtare Gjyqësore (2007- 2008) dhe si zyrtar i asociuar ligjor në Sektorin për Integrim Gjyqësor, (2002-2007). Z. Vicovac shërbeu si udhëheqës për rajonin, Pejë, Prizren & Mal të Zi, Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore, UN-Habitat (2002) dhe koordinator terreni, Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore, UN-Habitat (2000-2001). Z. Vicovac mban një titull doktorate në drejtësi nga Universiteti i Hamilit për drejtësi në Minesota si dhe ndoqi Universitetin e Manitobas dhe Universitetin e Oksfordit. Ai ka diplomuar për drejtësi dhe të drejtën në Universitetin e Uinipeg (Winnipeg). Artikulli i tij i titulluar, *“Sfidat për ofrimin e ndihmës ligjore personave të zhvendosur pas një konflikti të armatosur, mësimet e marra në Kosovë”* ishte publikuar nga Revista e Oksfordit për mbikëqyrjen e praktikimit të të drejtave të njeriut.
28. **Snezhana Martinoviq**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente ligjore ka punuar në Sekretariat që nga dhjetori i vitit 2007. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në prill të vitit 2000, si asistente administrative në Departamentin e Policisë së UNMIK-ut. Në tetor të vitit 2002, ajo mori detyrën e asistente administrative në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut.
29. **Adlije Muzaqi**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente e ekipit, ka punuar në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010. Ajo filloi punën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 1999, si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në Komunën e Vushtrisë, rajoni i Mitrovicës.

3. Mbulimi i aktivitetit të PKDNJ-së nga mediet dhe OJQ-të

30. Në vitin 2014, kishte një mbulim të rëndësishëm të mendimeve të Panelit për ankesat në lidhje me personat e zhdukur dhe të vrarë (PZHV), pasi fati i personave të tillë vazhdon të jetë një sferë për shqetësim në gjithë rajonin. Të dyja *Lajmet (Vesti)*, një organizatë lajmesh e cila përhap raportimin e vet në gjithë botën serbishtfolëse përmes shtypit dhe në mënyrë

elektronike përmes faqes së vet të internetit *Lajmet online (Vesti online)*, dhe *Zëri*, një organizatë lajmesh e përhapur gjerësisht në gjithë botën shqipfolëse, publikuan storie në lidhje me mendimet e Panelit për PZHV-të. Si shembull tipik, më 9 gusht 2014, *Lajmet (Vesti)* publikoi një storie rreth një mendimi të PKDNJ-së në një nga rastet e veta për PZHV-të dhe mungesën e hetimit dhe ndjekjes penale nga UNMIK-u dhe EULEX-i të rrëmbyesve të tij të pretenduar, pavarësisht se njëri nga ata thuhet ta ketë pranuar veprën⁷.

31. Në vitin 2014, Amnesty International (Amnestia Ndërkombëtare-AI) vazhdoi korrespondencën e vet me PSSP-në lidhur me mendimet e Panelit për PZHV-të. Më 6 shkurt 2014, AI i dërgoi një letër PSSP-së, në të cilën përsëriti shqetësimet e veta nga letra e vet drejtuar PSSP-së në gusht të vitit 2013 dhe Raportin e mëvonshëm të quajtur “*Trashëgimia e UNMIK-ut: dështimi për të ofruar drejtësi dhe dëmshpërblime të afërmve të të rrëmbyerve*”⁸ dhe kërkoi që UNMIK-u të ofrojë informata tjera mbi atë se si i ka trajtuar ato shqetësime. Reagimi i UNMIK-ut ndaj letrës së AI-së hasi në mbulim të rëndësishëm nga shtypi dhe mediet ndërkombëtare⁹.
32. Më 30 gusht 2014, AI publikoi një deklaratë të titulluar “*Serbia/Kosova: Koha për të realizuar të drejtën për të vërtetën, drejtësi dhe dëmshpërblim për viktimat e zhdukjeve të imponuara dhe rrëmbimeve*” në të cilën AI përsëri theksoi se UNMIK-u “kishte refuzuar t’u ofrojë dëmshpërblim familjeve të të zhdukurve për shkak të dështimit të kryejë hetime efektive, siç rekomandohet nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut.” AI përfundoi duke theksuar se ai “u bën thirrje të gjitha palëve në konflikt që të marrin çdo masë për t’i sjellë autorët para drejtësisë, dhe të sigurojnë se të afërmve të të gjithë personave të zhdukur u garantohet dëmshpërblimi, duke përfshirë kompensimin për dhimbjen dhe vuajtjen e shkaktuar nga humbja e anëtarit të tyre të familjes.”

4. Ngarkesa me lëndë e Panelit

4.1. Statistikat

33. Gjatë periudhës raportuese, nuk është pranuar asnjë ankesë e re, pasi 31 marsi i vitit 2010 ishte data e fundit për dorëzimin e ankesave të reja. Në periudhën mes viteve 2006 dhe 2010, Paneli pranoi gjithsej 527 ankesa.
34. Gjatë periudhës raportuese, Paneli miratoi 56 mendime mbi bazueshmërinë (lidhur me 96 ankesa), gjeti 2 ankesa tjera si pjesërisht të pranueshme, 1 ankesë e shpalli të papranueshme dhe 4 kërkesa i hodhi poshtë për rishikim të vendimeve të mëparshme.

⁷*Lajmet ‘online’ (Vesti online)*, 9 gusht 2014, “Otmičari priznali, Unmik i Euleks nemaju dokaza” (“*Rrëmbyesit pranuan, UNMIK-u dhe EULEX-i nuk kanë dëshmi*”).

⁸Për një diskutim të mëtejshëm të kësaj letrë të Amnesty International dhe reagimet e Panelit ndaj saj, ju lutem shihni Raportin Vjetor të PKDNJ-së për vitin 2013, §§ 36, 97-104.

⁹*Lajmet ‘online’ (Vesti online)*, 26 shkurt 2014, “Porodicama nestalih ni obeštećenja, ni izvinjenja” (“*As kompensim e as kërkim falje për familjet e personave të zhdukur*”); *Lajmet ‘online’ (Vesti online)*, 23 mars 2014, “Kosovo, zemlja nestalih i ubijenih - Umesto pravde stiglo Unmikovo pismo” (“*Kosova, një vend i të zhdukurve dhe i të vrarëve: Në vend të drejtësisë, arriti një letër nga UNMIK-u*”); *Politika online*, 3 mars 2014, “Unmik ne omogućava pravdu žrtvama na Kosovu” (“*UNMIK-u nuk ofron drejtësi për viktimat në Kosovë*”).

35. Në fund të vitit 2014, nuk kishte raste në zhvillim e sipër para Panelit në fazën e pranueshmërisë, dhe për 88 sosh pritet një mendim mbi bazueshmërinë. Paneli mbylli 97 lëndë në vitin 2014¹⁰.

4.2. Mendimet e Panelit të përzgjedhura sipas lëndës

36. Më poshtë janë një numër i mendimeve të dhëna në vitin 2014, të cekura sipas lëndës dhe të cilat janë theksuar për diskutim të mëtejshëm në pjesën 6 të këtij raporti:

E drejta në jetë– E drejta për hetim efektiv

- *Tatjana Vitosheviq dhe të tjerët*, 139/09 dhe të tjerët (mendimi i 23 janarit të vitit 2014)
- *Goran Knezheviq*, 141/09 (mendimi i 25 shkurtit të vitit 2014)
- *Srbolub Mitiq*, 63/09 (mendimi i 14 marsit të vitit 2014)
- *R.P.*, 120/09 & 121/09 (mendimi i 14 prillit të vitit 2014)
- *Biljana Radovanoviq*, 154/09 & 155/09 (mendimi i 29 majit të vitit 2014)
- *L.V. dhe të tjerët*, 291/09 dhe të tjerët (mendimi i 26 qershorit të vitit 2014)
- *Milica Mlladenoviq*, 99/09 (mendimi i 26 qershorit të vitit 2014)
- *Muharrem Ibraj*, 14/09 dhe të tjerët (mendimi i 6 gushtit të vitit 2014)
- *Dobrilla Antiq-Zhivkoviq*, (mendimi i 16 tetorit të vitit 2014)
- *Cica Jankoviq*, 249/09 (mendimi i 16 tetorit të vitit 2014)
- *Sllagjana Remishtar*, 245/09 (mendimi i 17 tetorit të vitit 2014)
- *Vuksan Bullatoviq*, 166/09 (mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014)
- *Liljana Mitroviq dhe të tjerët*, 144/09 dhe të tjerët (mendimi i 14 nëntorit të vitit 2014)
- *Lela Nikoliq dhe të tjerët*, 72/09 dhe të tjerët (mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014)
- *Marija Stevanoviq*, 289/09 (mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014)

E drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi-E drejta për gjykim të drejtë

- *Fillim Guga*, 47/08 (mendimi i 24 janarit të vitit 2014)
- *Nevenka Ristiq*, 319/09 (mendimi i 30 majit të vitit 2014)

5. Rastet e papërfunduara si më 31 dhjetor 2014

37. Paneli ka vazhduar punën në lëndët kryesore për të cilat pret të japë mendime në vitin 2015. Për shembull, lënda *Mon Balaj dhe të tjerët*, që përfshin pretendime për shkelje të së drejtës në jetë (neni 2 i KEDNJ-së) dhe të drejtës për tubim paqësor (neni 11 i KEDNJ-së) është afër përfundimit¹¹. Në rastin *Mon Balaj dhe të tjerët*, ankuesit pohojnë se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepërt gjatë operacionit për kontroll të turmës në Kosovë më 10 shkurt 2007, e cila rezultoi me vdekjen e dy viktimave dhe plagosjen e rëndë në trup të dy viktimave tjera.

¹⁰Për statistika të detajuara, shih Shtojcën C.

¹¹ Mendimi për rastin *Balaj dhe të tjerët* është miratuar më 27 shkurt 2015. Shih njoftimin për shtyp të Panelit: http://www.unmikonline.org/hrap/Documents%20HRAP/Press%20Releases%20Eng/04_07_Balaj_Press_Release%20_2mar15.pdf

38. Rasti tjetër akoma i papërfunduar është ai i *N.M. dhe të tjerët*, lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës në jetë, (neni 2 i KEDNJ-së) ndalim i trajtimit jonjerëzor apo degradues (neni 3 i KEDNJ-së) dhe, në mes tjerash, e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ-së). Në rastin *N.M. dhe të tjerët*, ankuesit, të cilët janë 143 pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, pohojnë se kanë vuajtur nga helmimi nga plumbi dhe probleme tjera shëndetësore për arsye të kontaminimit të dheut në vendet e kampimit në të cilat ata ishin vendosur nga UNMIK-u për shkak të afërsisë së kampeve me shkritoren e Trepçës dhe kompleksin e minierave dhe/apo për arsye të, përgjithësisht, kushteve të këqija higjienike dhe për jetesë në kampe.
39. Rasti i tretë kyç i papërfunduar është ai *Punëtorët e Kishnicës dhe Novobërdës të kompleksit Trepça*, lidhur me pretendimet për shkelje të së drejtës për shfrytëzim të patrazuar të pronave (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së), e drejta në punë (neni 6 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore [KNDESK]), e drejta për qasje në gjykatë (neni 6 i KEDNJ-së), e drejta për kompensim efektiv (neni 13 i KEDNJ-së), e drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi (neni 14 i KEDNJ-së), dhe ndalim i përgjithshëm i diskriminimit (neni 2, në lidhje me nenet 6, 9 dhe 11 të KNDESK), e drejta për sigurim social (neni 9 i KNDESK) dhe e drejta për një standard adekuat të jetesës (neni 11 i KNDESK). Në këtë rast, ankuesit, punëtorët joshqiptarë të kompleksit të minierave të *Trepçës*, ankohen se në qershor të vitit 1999, ushtarët e KFOR-it britanik me forcë i larguan ata nga kompleksi i minierave të *Trepçës*. Pas kësaj, megjithëse ata ruajtën statusin e punëtorit të ndërmarrjes, që nga qershori i vitit 1999 atyre as nuk u është paguar ndonjë pagë dhe as që janë vendosur nga UNMIK-u në një skemë alternative për përkrahje të qëndrueshme financiare.
40. Rast tjetër kyç është rasti *Tomë Krasniqi*, lidhur me pretendimet për shfrytëzim të patrazuar të pronave (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së), ndalim i trajtimit jonjerëzor dhe degradues (neni 3 i KEDNJ-së), e drejta për sigurim social (neni 9 i KNDESK) dhe e drejta për standard adekuat të jetesës (neni 11 i KNDESK). Në rastin *Tomë Krasniqi*, ankuesi pohon se të drejtat e tij janë shkelur për shkak të mosveprimit të UNMIK-ut në lidhje me pamundësinë e tij për të marrë pensionin e Serbisë.

6. Jurisprudenca e Panelit

41. Në vitin 2014, Paneli vazhdoi të bëjë përparim të rëndësishëm në trajtimin e ngarkesës së vet me lëndë. Në mbylljen e 97 rasteve që ishin në listën e vet, Paneli mori vendime dhe dha mendime që u dhanë ankuesve një shkallë të përfundimit ndërsa njëkohshëm zgjeroi jurisprudencën e Panelit në një numër çështjesh të reja procedurale dhe substanciale. Disa nga vendimet e marra dhe mendimet e dhëna nga Paneli në vitin 2014 përshkruhen në më shumë detaje më poshtë.

6.1. Çështjet e bazueshmërisë

6.1.1. E drejta në jetë – E drejta për hetim efektiv –neni 2 i KEDNJ-së

Mungesa e hetimit efektiv-Asnjë e dhënë për veprim substancial të ndërmarrë nga UNMIK-u

42. Në rastin *Ibraj*, ankuesi ankohej se gjashtë anëtarë të familjes së tij të ngushtë ishin rrëmbyer në periudhën mes 19 dhe 22 qershorit të vitit 1999 nga shtëpitë e tyre në fshatin Osek Hilë, Komuna e Gjakovës dhe pesë ishin vranë dikur pas kësaj (tjetri është zhdukur) dhe UNMIK-u nuk hetoi në mënyrë efektive krimet. Gjatë shqyrtimit të dosjes hetimore, Paneli theksoi se “ndryshe nga shumë raporte tjera për zhdukjet që ndodhën gjatë verës së vitit 1999, ishte e qartë në këtë rast që nga fillimi se të afërmit e ngushtë të ankuesit ishin marrë nga UÇK-ja, dhe nuk ishin parë më të gjallë. Prandaj, kishte baza për të dyshuar se këta persona në fakt u zhdukën në qartë rrethana kërcënimi për jetën. Megjithatë, autoritetet e UNMIK-ut nuk ndërmorën ndonjë veprim substancial për të hetuar këto rrëmbime, menjëherë apo në një kohë më vonë. Megjithëse informatat e nevojshme minimale rreth personave dhe anëtarëve tjerë të familjes ishin në dispozicion në dosje, deklaratat e tyre kurrë nuk janë regjistruar dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me autorët e pretenduar të identifikuar nga anëtarët e familjes. Policia madje nuk e vizitoi fshatin nga ku viktimat ishin marrë me qëllimin për të kuptuar më mirë rrethanat e zhdukjes, apo për të provuar për të gjetur ndonjë dëshmitar tjetër të rrëmbimeve. Po ashtu, në dosje nuk paraqitet asnjë përpjekje e policisë për të verifikuar lidhjen e mundshme të të dyshuarve, të përmendur me emër nga anëtarët e familjeve të viktimave, me rrëmbimet.” Paneli konstatoi që UNMIK-u kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për rrëmbimin dhe vrasjen (apo, në një rast, rrëmbimin dhe zhdukjen) e anëtarëve të familjes së ankuesit prandaj “[k]a pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.” Shih PKDNJ, *Ibraj*, lëndët nr. 14/09 dhe të tjerët, mendimi i 6 gushtit të vitit 2014, §§ 144, 162.

Marrëdhënia në mes hetimit të UNMIK-ut dhe hetimit të TNPJ-së

43. Në rastin *Remishtar*, ankuesja ishte e shqetësuar për mungesën e hetimit të UNMIK-ut për rrëmbimin dhe vrasjen e mundshme të z. Nenad Remishtar, i cili ishte subjekt i hetimit të njëkohshëm për rastin të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (TNPJ) në lëndën e vet nr. IT-04-84, *Haradinaj dhe të tjerët*. Paneli theksoi se “ai nuk e konteston primatin e përgjithshëm të TNPJ-së, sa i përket juridiksionit për të hetuar çdo krim brenda juridiksionit të vet të kryer në territorin e ish-Jugosllavisë, për shkak të statusit të vet të njohur ndërkombëtar sipas Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 827 (1993). Megjithatë, Paneli konsideron se aspekti, i cili nevojitet akoma të shqyrtohet nga perspektiva e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së, është nëse ndonjë obligim sipas këtij neni, përveç bashkëpunimit dhe ofrimit të ndihmës për TNPJ-në, bie mbi UNMIK-un gjatë periudhës së juridiksionit të Panelit.” Paneli theksoi se TNPJ-ja vazhdoi ta mbajë juridiksionin për çështjen “deri më 29 nëntor 2012, datën kur Paneli i Dhomës Gjyqësore i TNPJ-së dha vendimin e vet pas rigjykimit në rastin *Haradinaj dhe të tjerët*,” në të cilën pikë, për shkak se autorët nuk ishin gjetur, në pajtim me obligimin e vazhdueshëm për të hetuar, kompetenca për ta bërë këtë i ishte transferuar zyrtarisht EULEX-it, i cili më 9 dhjetor 2008 mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë. Paneli theksoi se “[a]tëherë u takon autoriteteve të EULEX-it t’i shfrytëzojnë mjetet në dispozicion të tyre për të shqyrtuar hetimin për të siguruar që asgjë nuk neglizhohet si dhe për t’i informuar të afërmit për progresin e këtij hetimi. Megjithatë, veprimi i autoriteteve, përveç UNMIK-ut, pas dhjetorit të vitit 2008 bie jashtë juridiksionit të Panelit.” Prandaj, Paneli përfundoi se, për aq sa ky hetim u atribuohet autoriteteve të UNMIK-ut, nuk ka

pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.” Shih PKDNJ, *Remishtar*, lënda nr. 245/09, mendimi i 17 tetorit të vitit 2014, §§ 104-120.

44. Ngjashëm, në rastin *Mitroviq dhe të tjerët*, ankuesja ishte e shqetësuar për mungesën e një hetimi të UNMIK-ut për rrëmbimin dhe zhdukjen e z. Sllobodan Mitroviq dhe viktimave tjera, të cilat ishin subjekt i hetimit të njëkohshëm të TNPJ-së në lëndën e vet nr.IT-03-66-A, *Limaj dhe të tjerët*. Paneli theksoi se TNPJ vazhdoi ta mbajë juridiksionin për çështjen “deri më 27 shtator 2007 datën kur Dhoma e Apelit e TNPJ-së dha vendimin e vet në rastin *Limaj dhe të tjerët*.” Paneli theksoi se, megjithëse ai vendim mbylli rastin e TNPJ-së, “duke pasur në konsideratë faktin se mbetjet mortore të viktimave nuk janë gjetur dhe as që janë sjellë para drejtësisë ata që ishin përgjegjës për rrëmbimin dhe zhdukjen e tyre... obligimi procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së nuk është përmbushur dhe është dashur të vazhdohej më tutje me [hetimin], megjithëse kishte kaluar një kohë e gjatë nga krimet e supozuara.” Prandaj, Paneli theksoi se, “në pajtim me obligimin e vazhdueshëm për të hetuar, kompetenca për ta bërë këtë i ishte transferuar zyrtarisht UNMIK-ut.” Megjithatë, Paneli konsideroi se “periudha njëvjeçare nga shtatori i vitit 2007 (që konsiderohet si fundi i juridiksionit të TNPJ-së mbi këto hetime) deri në dhjetor të vitit 2008 (fundi i autoritetit ekzekutiv të UNMIK-ut në Kosovë), është periudhë e pamjaftueshme për të bërë ndonjë vlerësim se sa ka qenë adekuat hetimi nga ana e UNMIK-ut. Prandaj, Paneli nuk ka asnjë bazë për të konstatuar shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së nga ana e UNMIK-ut.” Shih PKDNJ, *Mitroviq dhe të tjerët*, lëndët nr. 144/09 dhe të tjerët, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014, §§ 201-213.

Mungesa e hetimit efektiv për një zhdukje masive dhe vrasje

45. Në rastin *Mitiq dhe të tjerët*, ankuesi pohoi se UNMIK-u dështoi të hetojë efektivisht zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq dhe katër anëtarëve tjerë të familjes të cilët u zhdukën së bashku me 15 serbët e tjerë gjatë sulmit të UÇK-së në fshatin e tyre në qershor të vitit 1999. Paneli theksoi se “në kontekst të krimeve më serioze të kryera kundër popullatës civile, sipas nenit 2 kërkohet që autoritetet t’i bëjnë të gjitha përpjekjet hetimore me qëllim të vërtetimit të fakteve dhe sjelljes së autorëve para drejtësisë. Rasteve të tilla duhet dhënë prioriteti më i lartë.” Paneli gjithashtu theksoi që “nuk është bërë asnjë përpjekje nga autoritetet hetimore për të hetuar në një mënyrë sistematike dhe të koordinuar zhdukjen e rreth 20 personave nga fshati Mushtisht në qershor të vitit 1999 gjatë një sulmi të bashkërenduar nga UÇK-ja, i cili i duket Panelit të ketë qenë një operacion i pastrimit etnik.” Në këtë kuptim, Paneli konstatoi se “duke marrë në konsideratë seriozitetin dhe dimensionin e krimeve të kryera dhe gjithashtu dëmin e pësuar nga viktimat dhe familjet e tyre në rastet sikur ky, Paneli konkludon se UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për vrasjen e [viktimave]. Prandaj, ka pasur një shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.” Shih PKDNJ, *Mitiq dhe të tjerët* lëndët nr. 63/09 dhe të tjerët, mendimi i 14 marsit të vitit 2014, §§ 150,172, 178.

Mungesa e hetimit të mëtutjeshëm për Qendrën e mundshme të Paraburgimit të UÇK-së

46. Në rastin *R.D.*, ankuesja u ankua se burri dhe djali i saj ishin zhdukur në korrik të vitit 1999 dhe ishin vrarë ca kohë pas kësaj por UNMIK-u nuk kishte hetuar efektivisht për krimet. Paneli theksoi se në dosjen hetimore është treguar senë prill të vitit 2000 Policia e UNMIK-

- ut kishte pranuar një raport të inteligjencës sipas të cilit djali i ankueses, z. R.P., ishte mbajtur ilegalisht nga UÇK-ja në qendrën e paraburgimit në Skënderaj. Paneli theksoi me shqetësim se “nuk ka asnjë dokumentacion në dosje që tregon se Policia e UNMIK-ut mori ndonjë veprim për të verifikuar apo hetuar më tutje këtë informatë, jo vetëm sa i përket rastit të z. R.P. por gjithashtu sa i përket një hetimi më të gjerë që përfshin një model të mundshëm të rrëmbimeve dhe paraburgimeve ilegale të UÇK-së në gjithë Kosovën.” Shih PKDNJ, *R.D.*, lëndët nr. 120/09 & 121/09, mendimi i 14 prillit të vitit 2014, § 92.
47. Në rastin *L.V. dhe të tjerët*, ankuesit u ankuan se anëtarët e tyre të familjes janë rrëmbyer në zonën e Lipjanit më 22 qershor 1999 dhe janë vrarë apo me sa duket janë vrarë dikur pas kësaj por UNMIK-u nuk i kishte hetuar efektivisht krimet. Gjatë shqyrtimit të dosjes hetimore, Paneli theksoi se “është e qartë... se në prill të vitit 2000 Policia e UNMIK-ut kishte pranuar një raport të inteligjencës sipas të cilit anëtarët e familjeve të ankuesve, M.V., M.GJ. dhe D.S., ishin rrëmbyer nga një person i përmendur me emër dhe se po mbaheshin në atë kohë në burgun e UÇK-së në ‘Reçak-Komuna e Shtimes’... Paneli thekson me shqetësim se nuk është e qartë nga dosja hetimore se cilat veprime, nëse ka pasur ndonjë, ishin ndërmarrë nga Policia e UNMIK-ut për të verifikuar apo hetuar më tutje këtë informatë, jo vetëm për sa i përket rastit të M.V., M.GJ. dhe D.S., por gjithashtu sa i përket një hetimi më të gjerë që përfshin një model të mundshëm të rrëmbimeve dhe paraburgimeve ilegale të UÇK-së në gjithë Kosovën dhe Shqipërinë Veriore.” Shih PKDNJ, *L.V. dhe të tjerët*, lëndët nr. 147/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2014, § 122.
48. Në rastin tjetër të ngjashëm *Antiq-Zhivkoviq*, ankuesja u ankua se djali i saj ishte rrëmbyer nga pjesëtarët e UÇK-së më 28 korrik 1999 dhe që nga ajo kohë, vendndodhja e tij është e panjohur por UNMIK-u nuk e kishte hetuar efektivisht rrëmbimin e tij. Gjatë shqyrtimit të dosjes dhe materialit tjetër në lidhje me rastin, Paneli theksoi se “Emri i z. Zllatko Antiq përmendet në një dokument që daton nga tetori i vitit 2003 i përgatitur nga DD i UNMIK-ut për TNPJ-në, në të cilin përmbledhen informatat rreth një rrjetitë dyshuar trafikimi me qenie njerëzore të UÇK-së në mes Kosovës dhe Shqipërisë për qëllime prostitucioni të detyruar dhe marrje të organeve. Megjithëse nuk është përfshirë në dokumentet e ofruara nga PSSP-ja në lidhje me rastin e z. Zllatko Antiq, ky dokument tanimë është bërë publik dhe është paraqitur nga PSSP-ja si pjesë e dosjeve hetimore në lidhje me rastet tjera para Panelit. Sipas këtij dokumenti, z. Zllatko Antiq ishte në një grup të ‘të burgosurve’ që ishin dërguar në Shqipëri dhe ishin mbajtur në një objekt paraburgimi në Shqipërinë Veriore, në korrik apo fillim të gushtit të vitit 1999 për qëllime trafikimi me organe.” Paneli po ashtu theksoi se “më së voni deri në tetor të vitit 2003, DD i UNMIK-ut kishte pranuar informata nga dëshmitarët okularë, të gjithë ish-pjesëtarë të UÇK-së, se z. Zllatko Antiq ishte ndoshta në mesin e atyre të burgosurve të cilët ishin dërguar në qendrat ilegale të paraburgimit në Shqipëri, siç thuhet për qëllim të marrjes së organeve të tyre. Megjithatë, nuk ka asnjë indikacion në dosje se kjo pjesë e rëndësishme e informatave u ishte ofruar atyre që hetonin rastin e z. Zllatko Antiq apo se ishte ndërmarrë ndonjë veprim nga UNMIK-u për të hetuar më tutje këto pretendime më se serioze përveç transmetimit të informatave TNPJ-së në vitin 2003. Siç është theksuar në rastet tjera të ngjashme, Paneli është jashtëzakonisht i shqetësuar se ishin bërë aq pak përpjekje për të hetuar dhe vënë në jetë të drejtën për të ditur të vërtetën për sa u përket këtyre pretendimeve shokuese.” Shih PKDNJ, *Antiq-Zhivkoviq*, lënda nr. 147/09, mendimi i 16 tetorit të vitit 2014, §§ 37, 93.

Mungesa e hetimit efektiv për zhdukjen e një gazetari

49. Në rastin *Jankoviq*, Paneli konstatoi se UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e z. Marjan Melonashi, një gazetar i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Redaksia në gjuhën serbe (RTK) i cili është zhdukur në Kosovë më 6 shtator 2000. Paneli potencoi se, pavarësisht argumentit të PSSP-së se UNMIK-u “vazhdoi t’i vejë theks kryesor luftimit të dhunës së motivuar politikisht”, sipas mendimit të vet, “, zhdukja e një gazetari të njohur që punonte për një shërbim medial serb të RTK-së në mes të ditës dhe në mes të kryeqytetit ka të ngjarë të ketë qenë e lidhur me atë ‘dhunë të motivuar politikisht’. Megjithatë, autoritetet e UNMIK-ut nuk ndërmorën kurrë ndonjë veprim substancial për të hetuar zhdukjen e tij, menjëherë, apo në një kohë më vonë. Megjithëse informatat minimale të nevojshme për ankuesen dhe dëshmitarët e tjerë potencialë ishin në dispozicion në dosje, deklaratat e tyre nuk ishin regjistruar kurrë. Policia madje nuk e vizitoi shtëpinë apo vendin e punës të z. Melonashi, me qëllim që së paku t’i kuptojë më mirë rrethanat e zhdukjes.” ShihPKDNJ, *Jankoviq*, lënda nr. 249/09, mendimi i 16 tetorit të vitit 2014, §§ 49, 102.

Dështimet sistemore në hetimet e UNMIK-ut

50. Në rastin *Bullatoviq*, Paneli shkoi përtej dështimit specifik të UNMIK-ut që të hetojë efektivisht rrëmbimin dhe zhdukjen e viktimës për të theksuar dështimet sistemore lidhur me rastet e personave të zhdukur dhe/apo vranë. “Paneli e ka paraqitur në dosje se ai tanimë e ka analizuar efektivitetin, sipas nenit 2, të hetimeve të shumta të kryera nga UNMIK-u në lidhje me vrasjet, rrëmbimet dhe zhdukjet e ndërlidhura me konfliktin në Kosovë. Paneli i ka identifikuar mangësitë e përgjithshme në këto hetime siç janë vonesat në regjistrimin e rasteve dhe periudhat e gjata të mosaktivitetit që nga fillimi dhe në periudhën nën juridiksion të Panelit; dështimi për të ndërmarrë hapa themelore hetimorë dhe ndjekur pista të qarta të hetimit; mungesa e bashkërendimit në mes njësiteve të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut; mungesa e shqyrtimeve të rregullta dhe kuptimplota të rasteve; mungesa e mbikëqyrjes prokuroriale dhe dështimi për t’u ofruar anëtarëve të familjes informatat e nevojshme minimale për gjendjen e hetimit... Paneli gjithashtu regjistron dështimet sistemore sikur një sistem i mangët i vendosjes së prioriteteve dhe mungesa e pranim-dorëzimit të duhur. Në shumicën e këtyre rasteve Paneli ka gjetur se hetimet nuk ishin efektive në kuptim të nenit 2 dhe se dështimet e UNMIK-ut, të cilat vazhduan gjatë gjithë periudhës së juridiksionit të Panelit, nuk mund të justifikoheshin në dritë të vështirësive që UNMIK-u i hasi në fillim të misionit të vet.” Paneli po ashtu theksoi se “[N]ga ana e tij, Paneli, në dritë të mungesave dhe mangësive të përshkuara më lart, konsideron se rasti i z. Radovan Bullatoviq, dhe gjithashtu rastet e tjera të vrasjeve, rrëmbimeve dhe zhdukjeve të shqyrtuara më parë, paraqesin shembull të mirë të hetimeve sipërfaqësore dhe joproduktive të Policisë së UNMIK-ut për vrasjet dhe zhdukjet në Kosovë.” ShihPKDNJ, *Bullatoviq*, lënda nr. 166/09, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014, §§ 85, 101.

Përgjegjësia e UNMIK-ut për të kontaktuar dëshmitarët e zhvendosur gjatë hetimeve

51. Në rastin *Nikoliq dhe të tjerët*, ankuesit pohuan se UNMIK-u nuk kishte hetuar efektivisht për rrëmbimin dhe zhdukjen e të afërmeve të tyre të ngushtë dhe se ata ishin bërë persona të zhvendosur në Serbi duke u larguar nga Kosova pas qershorit të vitit 1999 për arsye sigurie. Paneli theksoi se “[k]jo është veçanërisht e rëndësishme në dritë të faktit se detajet

për kontakt të ankuesve në Serbi...ishin në dispozicion të Policisë së UNMIK-ut nga fillimi. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton nevojën e përgjithshme për të marrë parasysh cenueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, i takonte UNMIK-ut që t'i kontaktonte ata, dhe jo ata të kthehen në Kosovë, nga ku ata ishin larguar për shkaqe sigurie, në përpjekje për të zbuluar se çfarë u kishte ndodhur të afërmeve të tyre apo për hetim.” Shih PKDNJ, *Nikoliq dhe të tjerët*, lëndët nr. 72/09 dhe të tjerët, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014, § 198.

DD i UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut prioritzuan rastet në mënyrë jo të duhur

52. Në rastin *Stevanoviq*, ankuesja është ankuar se djali i saj është rrëmbyer nga persona të panjohur më 19 gusht 1999 derisa ishte duke udhëtuar me një veturë nga Fushë Kosova për në Podujevë dhe që nga ajo kohë, vendndodhja e tij është e panjohur, por UNMIK-u nuk e kishte hetuar efektivisht rrëmbimin e tij. Gjatë shqyrtimit të dosjes dhe materialit tjetër lidhur me rastin, Paneli i kushtoi “vëmendje të veçantë [një dokumenti në dosje] që ofron informata rreth një takimi që u mbajt në muajin nëntor të vitit 2003, në të cilin ishte vendosur përgjithësisht që ‘për shkak të kufizimeve në kohë, burime dhe personel, do të vazhdohej me hetimin vetëm të rasteve të caktuara dhe vetëm ato raste me një gjasë të fortë të identifikimit të të dyshuarit do të mbahen të hapura.’ Ky rast i veçantë është konsideruar se ‘nuk e plotësonte nivelin sa i përket provës, dëshmisë apo identifikimit të të dyshuarit për të mbetur i hapur’ dhe më pas, me urdhër të drejtorit të DD të UNMIK-ut, është mbyllur. Megjithëse ky takim u mbajt jashtë juridiksionit të përkohshëm të Panelit, efektet e tij të caktuara vazhdojnë brenda asaj periudhe. Prandaj, Paneli e konsideron të nevojshme ta komentojë atë. Megjithëse e njeh problemin e ngritur në takim, Paneli është seriozisht i shqetësuar nga një qasje e tillë e thjeshtë për zgjidhjen e tij, duke ndërprerë hetimin për krimin e rëndë të pretenduar.” Paneli po ashtu ritheksoi “qëndrimin e tij të shprehur në rastet tjera në lidhje me atë se sa janë adekuate hetimet për rrëmbime, zhdukje, vrasje dhe vdekje të dyshimta, se nuk duhet bërë asnjë prioritzim në fazat më të hershme, para se të jenë ndërmarrë hapa themelorë hetimorë drejt mbledhjes së informatave shtesë dhe para se të jetë mbledhur e gjithë dëshmia e arritshme.” Shih PKDNJ, *Stevanoviq*, lënda nr. 289/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014, §§ 112-114.

Hetimi i shpejtë nga Policia e UNMIK-ut – Dështimet pasuese në fazën gjyqësore

53. Në rastin *Mlladenoviq*, ankuesja është ankuar se djali i saj është rrëmbyer nga një grup i shqiptarëve të armatosur nga shtëpia familjare e shokut të tij në fshatin Gojbulë, Komuna e Vushtrrisë më 25 qershor 1999 dhe që nga ajo kohë, vendndodhja e tij është e panjohur, por UNMIK-u nuk e kishte hetuar efektivisht rrëmbimin dhe zhdukjen e tij. Pas shqyrtimit të dosjes hetimore, Paneli theksoi me shqetësim “se dosja nuk përmban vendim të prokurorit përgjegjës për të ndërprerë hetimin pas dështimit për të akuzuar [të dyshuarin e përmendur me emër], siç kërkohet me nenin 174 të Ligjit të Jugosllavisë mbi Procedurat Penale (LPP), apo një indikacion se ankuesja, familja e saj, apo familjet e dy personave tjerë të zhdukur u vunë në dijeni për atë vendim. Në pajtim me nenin 60 të LPP, një njoftim i tillë do t’u mundësonte atyre të vazhdojnë me ndjekjen subsidiare, nëse ata do ta dëshironin ta bëjnë këtë.”

54. Paneli po ashtu ka përmendur “qëndrimin e Gjykatës Evropiane në lidhje me natyrën e obligimit procedural sipas nenit 2, i cili ‘nuk është një obligim vetëm për arritjen e rezultateve por për përdorimin e mjeteve të duhura.’ Gjykata thekson qartas se nuk ka asnjë shkelje të nenit 2 nëse autoritetet marrin të gjithë hapat e arsyeshëm që ato mundën për të siguruar dëshmi lidhur me një incident dhe përfundimi i hetimit bazohet në analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante, madje edhe kur asnjë autor nuk është dënuar. Me qëllim të përmbushjes së kësaj kërkese, pasi ishte marrë një vendim që të mos ndiqej penalisht [i dyshuari i përmendur me emër], në vitin 2002, hetimi është dashur të synojë ose forcimin e dëshmisë kundër tij, apo t’i gjejë autorët e vërtetë. Megjithatë, në dosje nuk ka çfarëdo qoftë indikacioni për sa i përket ndonjë veprimi pasues substancial hetimor të ndërmarrë nga policia. Poashtu, nuk duket të jetë ndërmarrë asnjë veprim nga prokurorët ndërkombëtarë në lidhje me kallëzimin penal të ankueses, i cili ishte pranuar dhe përkthyer nga UNMIK-u në shkurt të vitit 2005.”
55. Paneli po ashtu e ndjeu të nevojshme të përmend faktin se “dy të mbijetuarit...të cilët ia kishin dhënë më herët deklaratat e tyre policisë dhe gjyqtarit hetues dhe e kishin identifikuar pozitivisht [të dyshuarin e përmendur me emër] në koleksionin me shumë fotografi si njërin nga autorët, ishin të obliguar gjatë procedurave të gjyqit të marrin pjesë në një paradë identifikimi, duke u përballur me [të dyshuarin e përmendur me emër] personalisht. Gjatë veprimit të fundit, vetëm njëri nga të mbijetuarit e identifikoi atë gjatë përpjekjes së dytë. Paneli është i shqetësuar se një praktikë e tillë, kur të mbijetuarit duhet të përballen me personin i cili kishte provuar me forcë t’i rrëmbejë ata, ka shumë të ngjarë t’u shtojë atyre trauma psikologjike të cilat ata tanimë i kanë përjetuar. Megjithëse veprimi i tillë mund të justifikohet me qëllim të mbështetjes së parimit të drejtësisë, ai duhet kryer me kujdes të jashtëzakonshëm. Ky është veçanërisht rasti në situatat ku dëshmitarët apo viktimat mund të jenë nën presion për të ndryshuar deklaratat e tyre. Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm për problemin e paraqitur shpesh në Kosovë në lidhje me mungesën e mbrojtjes së dëshmitarëve nga kërcënimet apo frikësimi, ‘i cili ka qenë, dhe mbetet, një nga sfidat më të mëdha për autoritetet e drejtësisë’. Disa observues theksojnë se ‘[d]ëshmitarët, të cilët në shumë raste janë vendimtarë për lidhjen e të pandehurve me krimet për të cilat ata akuzohen, janë duke u bërë më hezitues për të dëshmuar para institucioneve, le të jenë ato të policisë, prokurorë dhe/apo gjykatës në gjykata’. Në këtë rast të veçantë, një dëshmitar anonim ishte kërcënuar në telefon natën para paraqitjes në gjykatë sipas orarit, dhe më pas refuzoi të dëshmonte.”
56. Duke vënë në duke këto çështje, në mes tjerash, Paneli përmendi se “ndryshe nga shumë raste tjera të ngjashme para Panelit, në këtë policia kërkoi aktivisht informata dhe pista të hetimit, megjithëse me një vonesë, dhe faktikisht i gjeti ato”; megjithatë, “UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për rrëmbimin dhe zhdukjen e viktimës,” siç kërkohet me nenin 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural. Shih PKDNJ, *Mlladenoviq*, lënda nr. 99/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2014, §§ 186-190, 200.

6.1.2. Mosdiskriminimi – neni 14 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

Diskriminimi kundër pjesëtarëve të komuniteteve minoritare

57. Në dy raste diskriminimi para Panelit, ankuesit paraqitën ankesa duke pretenduar se në procedurat para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), ata ishin diskriminuar për shkak të etnisë së tyre minoritare. Në të dy rastet, Paneli theksoi qartas se nuk ishte në kuadër të juridiksionit të vet të veprjës si tribunal i instancës së katërt, duke mbikëqyrur vendimet e Dhomës së Posaçme. Paneli theksoi pa mëdyshje se “nuk është në kuadër të juridiksionit të vet të zëvendësojë vlerësimin e tij të fakteve për atë të autoriteteve gjyqësore nacionale, në rastin aktual të Dhomës së Posaçme. Paneli i referohet jurisprudencës së vet dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se, si rregull e përgjithshme, u takon gjykatave kompetente të vlerësojnë dëshminë para tyre, vërtetojnë faktet dhe interpretojnë ligjet vendore. Paneli, në parim, nuk do të interferojë me një vlerësim të tillë veç nëse vendimet e marra nga gjykatat kompetente duken arbitrare dhe qartas të paarsyeshme. Detyra e Panelit është të konstatojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën me të cilën është vlerësuar dëshmia, ishin të drejta.”
58. Në rastin e parë, *Guga*, ankuesi pohoi se ai ishte përjashtuar padrejtësisht nga lista e punëtorëve gjatë privatizimit të ish-punëdhënëses së tij, kompania IMN dhe më pas, gjatë procedurave të AKM-së (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) dhe Dhomës së Posaçme ai ishte diskriminuar për shkak të etnisë së tij egjiptiane. Në mënyrë specifike, ankuesi kishte pohuar se e drejta e tij për të qenë i lirë nga diskriminimi është shkelur, sepse në rastet e tjera Dhoma e Posaçme vendosi në favor të pretenduesve, serbëve dhe minoriteteve të tjera, të cilët, sikur ankuesi, i kishin pasur marrëdhëniet e punës të ndërprera sepse ata u larguan nga Kosova në vitin 1999-2000, për shkak të situatës së sigurisë. Ankuesi kishte deklaruar se në ato raste, Dhoma e Posaçme pranoi pretendimet e tyre për t’u përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar dhe se kjo është vendosur madje edhe kur ata (ndryshe nga ai) nuk kishin inicuar ndonjë procedurë gjyqësore. Ankuesi gjithashtu deklaroi qartë se Dhoma e Posaçme nuk i ka qartësuar arsyet pse ankesa e tij është gjykuar ndryshe. Ai pohoi se është diskriminuar për shkak të etnisë së tij egjiptiane.
59. Paneli shqyrtoi parashtrësit e ankuesit para AKM-së dhe Dhomës së Posaçme, në mënyrë specifike për sa i përket pohimit të ankuesit se ai i kishte paraqitur faktet para Dhomës së Posaçme për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit, siç kërkohet me ligjet relevante në Kosovë për punëtorët që kundërshtojnë mospërfshirjen e tyre në listën e punëtorëve gjatë privatizimit të një ndërmarrjeje. Paneli theksoi se, “në përkrahje të pretendimeve të tij, ankuesi i dorëzoi fakte dhe gjithashtu dëshmi dokumentuese AKM-së dhe Dhomës së Posaçme se - ai kishte punuar në IMN për afërsisht 20 vjet, deri në mars-qershor të vitit 1999; se kur shpërthyen armiqësitë në Kosovë në vitin 1999, duke iu frikësuar persekutimit për shkak të etnisë së tij egjiptiane, ai u largua si refugjat në Mal të Zi dhe kështu nuk mundi të punojë më gjatë në ndërmarrje; se për këtë arsye marrëdhënia e tij e punës në IMN i ishte ndërprerë; se pas një kohe të caktuar, ai kishte bërë përpjekje të rifillojë punën në IMN, pa sukses.” Pas kësaj, Paneli theksoi se Dhoma e Posaçme hodhi poshtë ankesën e tij por “pavarësisht nga pesha e parashtrësive të ankuesit, vendimi i Dhomës së Posaçme nuk specifikoi arsyet se pse faktet e paraqitura nga ankuesi konsideroheshin të pamjaftueshme për të krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit apo se si ishte vlerësuar dëshmia e paraqitur nga ankuesi.”

60. Paneli vlerësoi më tutje “qëndrimin e ndryshëm të miratuar nga Dhoma e Posaçme në rastet e tjera të privatizimit, nga qershori i vitit 2004 e më tutje, për sa i përket pretendimit të ish-punëtorëve se ata do të ishin të kualifikuar për t’u përfshirë në listë nëse ata nuk do të ishin diskriminuar.” Paneli theksoi dy rastet e tjera ku arsyetimi i Dhomës së Posaçme ndryshonte konsiderueshëm për këtë çështje dhe ku ai përfundimisht pranoi të drejtën e punëtorëve serbë të marrin një pjesë të të ardhurave. Pas kësaj Paneli theksoi se Gjykata Evropiane “ka konsideruar se ekzistenca e divergjencave madje brenda gjykatës së njëjtë nuk mundet vetvetiu të konsiderohet në kundërshtim me Konventën; sidoqoftë, mund të ketë raste ku divergjencat në praktikën gjyqësore çojnë kah gjetja e një shkelje të nenit 6 [të KEDNJ-së].” Paneli konstatoi në këtë rast se “Dhoma e Posaçme nuk ofroi një sqarim të kënaqshëm se pse për këtë rast ishte vendosur ndryshe nga rastet e pjesëtarëve tjerë të pakicave nacionale në situatën e njëjtë faktike.”
61. Paneli po ashtu theksoi “situatën e cenueshmërisë në të cilën minoritetet e zhvendosura e gjetën veten në Kosovë si pasojë e konfliktit, dhe në veçanti cenueshmërinë e mëtutjeshme të këtyre individëve, sikur ankuesi, duke u takuar minoriteteve joserbe. Në pajtim me qëndrimin e shprehur më herët të Panelit në rastin *Parliq*, situata e tyre kërkoi miratimin e masave pozitive mbrojtëse nga autoritetet për t’u kushtuar rëndësi të veçantë të drejtave të tyre fundamentale, duke përfshirë të drejtat në kuadër të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë.” Paneli përfundoi se “Dhoma e Posaçme i zbatoi ato dispozita në rastin aktual, pa marrë në konsideratë situatën e veçantë të ankuesit si pjesëtar i një minoriteti etnik, persekutimi i të cilit si pasojë e konfliktit ishte çështje e njohurisë së përgjithshme.” Në këtë kuptim, pasi “Ankuesi i ka paraqitur atij fakte të mjaftueshme për të provuar se Dhoma e Posaçme e trajtoi atë ndryshe nga të tjerët në një situatë analoge... Paneli përfundon se ka pasur shkelje të nenit 14 [të KEDNJ-së], në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.” Shih PKDNJ, *Guga*, lënda nr. 47/08, mendimi i 24 janarit të vitit 2014, §§ 68-81, 86-87.
62. Në rastin e dytë, *Ristiq*, ankuesja pretendonte se atë e kishte përjashtuar padrejtësisht Dhoma e Posaçme nga lista e punëtorëve të kualifikuar që të marrin një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjes për të cilën kishte punuar. Në veçanti, ankuesja deklaroi se Dhoma e Posaçme nuk e mori parasysh dëshminë e dokumentuar, do të thotë një kopje të vërtetuar të librezës të saj të punës, që dëshmonte për punësimin e saj në “Eximkos” që nga viti 1975, dhe gjithashtu parashtresën e saj se ajo ishte diskriminuar për shkak të etnisë së saj serbe. Paneli shqyrtoi parashtresat e saj për AKM-në dhe Dhomën e Posaçme dhe theksoi se “në përkrahje të pohimit të saj, ankuesja ia paraqiti faktet dhe gjithashtu dëshminë dokumentuese AKM-së dhe Dhomës së Posaçme se ajo kishte punuar në ndërmarrje për përafërsisht 24 vjet deri në mars të vitit 1999; se kur armiqësitë shpërthyen në Kosovë në vitin 1999, duke pasur frikë nga persekutimi për shkak të etnisë së saj, ajo u largua si person i shpërngulur për në Mal të Zi dhe kështu nuk mund të punonte më në ndërmarrje. Paneli thekson se ankuesja gjithashtu i paraqiti një parashtresë Dhomës së Posaçme se ankesa e paraqitur kundër përfshirjes së saj në listë ishte e motivuar etnikisht.”
63. Paneli pastaj theksoi se “[M]egjithatë, Dhoma e Posaçme dështoi ta zbatojë [dispozitën relevante] të Ligjit Kundër Diskriminimit; ajo pohoi se ankuesja ‘nuk dëshmoi se ajo ishte diskriminuar’ dhe kështu nuk kërkoi nga punëtorët që kundërshtonin përfshirjen e saj në

listë t'i rrëzonin pohimet e ankueses për diskriminim. Dhe Dhoma e Posaçme as që dha ndonjë arsye për këtë. Prandaj, Paneli konsideron se Dhoma e Posaçme ka vepruar në mënyrë diskriminuese përmes dështimit të saj për të marrë parasysh diskriminimin e përjetuar nga ankuesja dhe dështimit të saj që ta ndryshojë peshën e dëshmisë siç kërkohet me [dispozitën relevante] të Ligjit Kundër Diskriminimit... Prandaj, Paneli përfundon se ka pasur shkelje të nenit 14 [të KEDNJ-së], në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së." Shih PKDNJ, *Ristiq*, lënda nr. 319/09, mendimi i 30 majit të vitit 2014, §§ 53, 73-78.

7. Rekomandimet e Panelit

64. Në vitin 2014, Paneli miratoi mendime mbi bazueshmërinë në 88 raste ku konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut, për të cilat UNMIK-u ishte përgjegjës dhe mendime mbi bazueshmërinë në 8 raste ku nuk konstatoi asnjë shkelje të të drejtave të njeriut. Në secilin nga këto raste ku ishin konstatuar shkelje, Paneli konsideroi se ishte e nevojshme një formë e kompensimit. Këtë vit, si në dhjetë vjetët e kaluara, Paneli e kishte disi si problematike të vendosë se çfarë rekomandimesh të japë në një situatë ku UNMIK-u nuk është më në gjendje të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet që merren në Kosovë. Siç është theksuar më lart, UNMIK-u nuk mundet më të ndryshojë legjislacionin sipas nevojës (apo në çdo rast, madje edhe nëse ndryshohet legjislacioni relevant, ai nuk mund të sigurojë më zbatimin e tij), e as që mund t'i udhëzojë autoritetet e Kosovës t'i korrigjojnë të metat e tjera të identifikuar nga Paneli. Kjo situatë kërkonte që Paneli të jetë i njohur me kufizimet e tilla derisa jep rekomandime që mund të kenë ndikim pozitiv për sa i përket situatës së të drejtave të njeriut të ankuesve të dëmtuar.
65. Në 157 prej 168 rasteve për PZHV-të të shqyrtuara që nga fillimi i aktivitetit të Panelit, ai konstatoi se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, në mënyrë specifike përmes dështimit të kryejë hetim adekuat dhe efektiv për zhdukjen apo rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmeve të ankuesve. Në këto raste, Paneli mori një këndvështrim më të gjerë për dëmshpërblimet dhe rekomandoi që UNMIK-u të marrë siguri nga EULEX-i, se hetimet do të vazhdojnë në pajtim me kërkesat e nenit 2, që rrethanat që ndërliken me zhdukjen dhe vrasjen e viktimave do të tregohen dhe autorët do të sillen para drejtësisë; që ankuesi dhe/apo të afërmit duhet të informohen për veprimet e tilla dhe dokumentet relevante do t'u zbulohen atyre sipas nevojës. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, duke përfshirë mediet, përgjegjësinë për dështimin e vet për të hetuar në mënyrë adekuate zhdukjen dhe vrasjen e viktimave dhe t'u kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre në lidhje me këtë. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u t'i paguajë kompensim adekuat ankuesit për dëmin e shkaktuar moral për shkak të dështimit të UNMIK-ut për të kryer hetim efektiv.
66. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të nevojshëm, përmes organizmave të tjerë të afërt me OKB-në që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe organizatave joqeveritare, për krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmbushjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat nga të gjitha komunitetet që kanë qenë subjekt i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij. Në fund, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë

Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që të ndajë burime adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar që standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur.

67. Në 108 raste për PZHV-të të shqyrtuara që nga fillimi i aktivitetit të Panelit, ai konstatoi se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, Paneli konstatoi se qëndrimi i UNMIK-ut ndaj ankuesve dhe familjeve të tyre lidhur me hetimet për zhdukjen, rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmeve të tyre kontribuoi që ankuesit dhe familjet e tyre të përjetojnë shqetësim të rëndë, e që është në kundërshtim me të drejtën për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues. Prandaj, përveç se ka rekomanduar të gjitha dëmshpërblimet lidhur me shkeljet e nenit 2 të KEDNJ-së, Paneli rekomandoi që UNMIK-u po ashtu t'u paguajë kompensim adekuat ankuesve për dëmin moral në lidhje me shkeljet e tij të nenit 3 të KEDNJ-së.
68. Në rastet e shkeljeve të dispozitave tjera, sikur shkeljet e nenit 14, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Paneli rekomandoi kompensim për dëmin e shkaktuar jopasuror (jomaterial) si rezultat i diskriminimit. Paneli po ashtu rekomandoi në një rast, *Guga* (shih §§ 58-61 më lart), që UNMIK-u t'u kërkojë EULEX-it dhe autoriteteve të tjera kompetente në Kosovë që të veprojnë në drejtim të rishqyrtimit nga Dhoma e Posaçme të ankesës së ankuesit për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi, nëse ai e dëshiron këtë. Në rastin tjetër, *Ristiq* (shih §§ 62-63 më lart) Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u t'u kërkojë EULEX-it dhe autoriteteve të tjera kompetente në Kosovë që të ndërmarrin hapa për të mundësuar rihapjen e rastit të ankueses nga Dhoma e Posaçme dhe shqyrtimin e tij në pajtim me standardet e KEDNJ-së, nëse ankuesja e dëshiron këtë.
69. Në çdo ankesë deri më tani në të cilën Paneli ka konstatuar shkelje, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të marrë masa të menjëhershme dhe efektive për t'i zbatuar rekomandimet e tij dhe të informojë ankuesin dhe Panelin rreth zhvillimeve të mëtejme për rastin. Megjithatë, Paneli i zhgënjyer raporton se UNMIK-u nuk ka zbatuar pothuaj asnjë nga rekomandimet e Panelit.

8. Reagimet e UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit

70. Paneli thekson se neni 17.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që PSSP-ja ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit, ndërsa neni 17.4 kërkon që vendimet e PSSP-së "të botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to." Paneli është i inkurajuar të theksojë se UNMIK-u ka vazhduar të bëjë përpjekje për të publikuar më shumë përgjigje në mendimet e Panelit se në vitet e mëparshme, duke publikuar 99 sish në vitin 2014. Sidoqoftë, natyra e përgjigjeve të UNMIK-ut, e kombinuar me dështimin e UNMIK-ut për të arritur të ndonjë dëmshpërblim praktik apo përfitim për ankuesit, tregon për një mungesë të angazhimit efektiv të PSSP-së lidhur me punën substanciale të Panelit.

8.1. Vazhdimi i hetimeve

71. Për sa i përket përgjigjes së PSSP-së ndaj mendimeve të Panelit për PZHV-të, në vitin 2013 EULEX-i krijoi në Task Forcë, të udhëhequr nga një prokuror ndërkombëtar, i cili shqyrton këto hetime të papërfunduara për PZHV-të dhe është i ngarkuar për t'u dhënë rekomandime prokurorëve dhe Policisë së EULEX-it rreth asaj se si të vazhdohet më tutje. Në vitin 2014, Sekretariati i Panelit vazhdimisht informoi PSSP-në se asnjë informatë nuk ishte ofruar nga EULEX-i lidhur me ndonjë hetim të mëtejshëm, që e kishte kryer në ndonjë nga rastet e Panelit për PZHV-të që atyre ua kishte dorëzuar UNMIK-u. Në fakt, Sekretariati kishte pranuar informata se disa nga rastet e Panelit për PZHV-të ishin mbyllur nga EULEX-i para se ato t'i jenë përcjellë nga UNMIK-u dhe me sa duket as nuk janë rihapur e as rishqyrtuar pas rekomandimeve të PKDNJ-së. Më shumë se një vit pas krijimit të Task Forcës së EULEX-it, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë rezultat të prekshëm që është arritur nga ajo. Përveç kësaj, Sekretariati është informuar se disa nga rastet u janë transferuar autoriteteve lokale.
72. Paneli thekson se në letrën e tij të 6 shkurtit të vitit 2014 (shih § 31 më lart), Amnesty International e pyeti UNMIK-un lidhur me informatën “nëse Policia e EULEX-it kishte filluar ndonjë hetim të ri, apo rihapur hetimet për ndonjë nga rastet e personave të zhdukur të përfshirë në mendimet e Panelit.” Në përgjigje, PSSP-ja theksoi se ndërsa “Zyrtarët e UNMIK-ut dhe unë e kemi trajtuar këtë çështje me EULEX-in gjatë takimeve tona ...vetëm EULEX-i do të jetë në gjendje t'u ofrojë juve informata më të detajuara për iniciimin e rasteve të reja apo rihapjen e hetimeve për rastet e personave të zhdukur.” Paneli thekson me shqetësim se me gjithë rekomandimin që UNMIK-u të marrë siguri nga EULEX-i se hetimet do të vazhdonin në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 2, me sa duket UNMIK-u nuk ka marrë ndonjë siguri nga EULEX-i rreth vazhdimet të hetimeve dhe siç duket nuk është i gatshëm ta bëjë këtë.

8.2. Kërkim faljet publike

73. Përveç kësaj, siç ka rekomanduar Paneli po ashtu në Raportin Vjetor për vitin 2013, për sa i përket rekomandimit të Panelit që PSSP-ja t'u kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre për hetimin joefektiv, PSSP-ja deri tani u ka dërguar letër shumë ankuesve, në të cilën ai thotë: “Unë shpreh keqardhje të thellë se kishte mungesë të hetimit efektiv për rrëmbimin dhe vdekjen e [të dashurit] tuaj i cili u ka shkaktuar juve shqetësim shtesë dhe vuajtje mentale.” Në letrën e vet të 6 shkurtit të vitit 2014 për PSSP-në, AI theksoi, “Amnesty International është në dijeni se ankuesit kanë marrë letra personale nga ju. Megjithatë, ne po ashtu e kuptojmë se shumë konsiderojnë se kjo është shumë larg nga të qenit adekuate si një kërkim falje publike, e cila ishte rekomanduar, dhe të cilën ata vazhdojnë ta kërkojnë.” PSSP-ja u përgjigj se “përveç letrave individuale për ankuesit, të gjitha vendimet dhe përgjigjet e mia në rekomandimet e Panelit janë bërë publike në një forum publik, në faqen e internetit të PKDNJ-së.”
74. Paneli pajtohet me shqetësimet e AI-së rreth letrave personale të PSSP-së drejtuar ankuesve. Siç ka theksuar Paneli më parë, ai konsideron se letrat e PSSP-së nuk paraqesin as kërkim falje kuptimplota e as kërkim falje publike. Për sa u përket letrave që nuk paraqesin kërkim falje kuptimplota, Paneli konsideron se nëse letra e PSSP-së do të përfshinte deklarata të rëndësishme për të ndërmarrë veprim korrigjues me qëllim që në ndonjë mënyrë të lehtësohet vuajtja e ankuesve, atëherë kjo mund të paraqesë një kërkim

falje publike. Megjithatë, PSSP-ja vazhdon të qëndrojë pas mendimit se një shprehje e keqardhjes së thellë, pa diçka më shumë, është e mjaftueshme. Paneli nuk pajtohet me këtë. Për sa i përket karakterit publik të kërkim faljes, Paneli konstaton se kjo letër e vetme për ankuesni nuk paraqet një kërkim falje publike, dhe nuk bëhet kërkim falje publike vetëm duke e vendosur atë në faqen e internetit të Panelit në një format që nuk është lehtësisht i identifikueshëm për personat që nuk janë të njohur me rastin specifik. Për këtë arsye, duke filluar nga tetori i vitit 2014, në rastet për PZHV-të ku Paneli ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut, rekomandimet e Panelit kanë përfshirë atë që PSSP-ja duhet “të pranojë publikisht, duke përfshirë mediet, dështimin e UNMIK-ut për të kryer hetim efektiv”. Megjithatë, prej publikimit të këtij raporti, Paneli nuk ka parë ndonjë ndryshim në mënyrën që PSSP-ja e ka bërë këtë kërkim falje, dhe nuk është informuar që PSSP-ja ka përdorur ndonjë medie për këtë qëllim.

8.3. Kompensimi

75. Në lidhje me rekomandimin e Panelit që PSSP-ja të ndërmarrë hapa për të krijuar një program të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmbushjen dhe garancitë, Paneli përsërit me shqetësim se PSSP-ja vazhdon të mohojë përgjegjësinë e UNMIK-ut. Në përgjigje të rekomandimeve të Panelit, PSSP-ja vazhdon të informojë ankuesit se “Unë dua të sjell ndër mend se aktet në pyetje kanë të bëjnë me aktivitetet e kryera nga institucionet e krijuara nën administrimin e përkohshëm të Kosovës. Në këtë kuptim, nëse UNMIK-u do të vazhdonte të ketë kontroll mbi këto institucione sot, UNMIK-u do të ishte në pozitë t’ua përmend rekomandimet e Panelit atyre institucioneve për veprim të duhur.” Kjo është formula se si UNMIK-u ka zgjedhur t’i informojë ankuesit se nuk do të ketë kompensim të paguar nga UNMIK-u për shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e tij. AI, mes tjerash, ka theksuar se “Amnesty International konsideron se kjo përgjigje... paraqet një përpjekje të pazakontë të UNMIK-ut për të mohuar përgjegjësinë e vet për shkeljet e shumë standardeve për të drejtat e njeriut për të cilat ishte krijuar t’i mbështesë dhe respektojë.”¹²
76. Në letrën e vet të 6 shkurtit për PSSP-në, AI përsëri i kërkoi PSSP-së “të sigurojë që UNMIK-u të ketë krijuar fonde të mjaftueshme në dispozicion për t’u ofruar të afërmeve të të zhdukurit kompensim adekuat dhe efektiv për dëmin moral kur rekomandohet nga PKDNJ ...” Në përgjigje, PSSP-ja përsëriti argumentet e tij të mëhershme. “Për sa i përket ofrimit të kompensimit adekuat ankuesve, qëndrimi i UNMIK-ut nuk ka ndryshuar që nga viti 2012. Siç është theksuar më herët, që nga qershori i vitit 2008, UNMIK-u nuk ka më kontroll mbi Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, nga i cili duhen paguar kompensimet e rekomanduara nga PKDNJ. Kontrolli buxhetor tani ushtrohet vetëm nga autoritetet e Kosovës. Të deklaruarit se unë jam i përgatitur të diskutojë mundësinë e krijimit të një mekanizmi për të trajtuar çështjet e tilla me autoritetet relevante është pasojë logjike e paaftësisë së UNMIK-ut për të paguar kompensimet e rekomanduara nga Paneli im Këshillëdhënës.”
77. Paneli ripohon se duhet të jetë përgjegjësi e OKB-së të paguajë kompensimin për shkeljet e të drejtave të njeriut, pasi këto shkelje i atribuoheshin UNMIK-ut. Në fakt, megjithëse PSSP-ja kishte dhënë një përgjigje para ca vitesh se “UNMIK-u do të vazhdojë t’ia tërheq

¹² Për diskutim të mëtejme të kësaj pike, shih Raportin Vjetor të Panelit për vitin 2013, §§ 100-104.

vëmendjen Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për nevojën për të rishqyrtuar rregullat e tanishme për kompensim, të cilat përjashtojnë pagesën e kompensimit për dëmin jopasuror (jomaterial)”, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë përpjekje të tillë të bërë nga PSSP-ja. Në përgjigjet më të fundit për ankuesit, PSSP-ja ka theksuar se, “Unë jam i përgatitur të diskutojë mundësinë e krijimit të një mekanizmi për të trajtuar çështjet e tilla me autoritetet relevante në rrethana të duhura.” Paneli po ashtu nuk është në dijeni për ndonjë diskutim të tillë, përkundër asaj se janë bërë pyetje vazhdimisht rreth kësaj çështje nga Sekretariati, ankuesit dhe AI. Është po ashtu e vlefshme të theksohet se megjithëse Sekretari i Përgjithshëm i paraqet raporte tremujore Këshillit të Sigurimit për UNMIK-un, i hartuar nga informatat që atij ia ofron PSSP-ja, nuk ka pasur asnjë raportim për PKDNJ-në apo mendimet e tij që nga gushti i vitit 2012.¹³

78. Paneli raporton i dekurajuar se shumë nga ankuesit vazhdojnë t’i drejtohen Sekretariatit të Panelit pas pranimit të mendimeve në përgjigje të ankesës së tyre që rekomandojnë që OKB-ja t’i kompensojë ata për shkeljen e të drejtave të njeriut. Këta ankues, të inkurajuar se ata mund të pranojnë miratim për t’i mbështetur për vuajtjen e tyre, i kanë kërkuar Sekretariatit të Panelit t’u tregojë se çfarë ata duhet të bëjnë tani me qëllim që përfundimisht të marrin këtë kompensim. Në këtë kohë, Sekretariati vetëm mund t’i informojë ata se ata duhet të kërkojnë informata tjera nga PSSP-ja, megjithëse Paneli e ka gjithnjë e më shumë të qartë se PSSP-ja nuk ka më tutje informata valide për t’ua dhënë atyre, përveç “që të jetë i përgatitur të diskutojë mundësinë e krijimit të një mekanizmi për të trajtuar çështjet e tilla me autoritetet relevante në rrethana të duhura.” Megjithatë, madje edhe ky hap i vogël nuk është bërë.
79. Paneli përsëri thekson se, pavarësisht nga procesi i vet i gjatë për të ofruar vendime mbi pranueshmërinë, mendime, dhe rekomandime, UNMIK-u mbetet në parim i papërgjegjshëm për shkeljet e veta të të drejtave të njeriut. Paneli, i cili është krijuar për të ofruar ca mbikëqyrje të pajtueshmërisë së UNMIK-ut me standardet për të drejtat e njeriut, nuk ka qenë në gjendje të ketë sukses në këtë funksion. Siç qëndron çështja tani, Paneli nuk sheh ndonjë aktivitet kuptimplotë të ndërmarrë nga UNMIK-u në përgjigje të rekomandimeve të tij. Ky mosveprim ka siguruar që i gjithë projekti prej shtatë vitesh i PKDNJ-së të mos ofrojë asnjë përfitim të prekshëm për shumicën e ankuesve. Prandaj, Paneli shpreh keqardhje se për shkak të inercisë së UNMIK-ut, nuk ka pasur kompensim për ankuesit. Në këtë kuptim, ata janë viktimizuar dy herë nga UNMIK-u: nga shkeljet e para të të drejtave të njeriut të kryera kundër tyre dhe përsëri duke ua lënë shpresën dhe besimin e tyre në këtë proces. Paneli edhe njëherë këshillon UNMIK-un dhe Organizatën

¹³ Në raportin e 3 gushtit të vitit 2012 u njoftua për emërimin e ish-anëtarit të Panelit (z. Paul Lemmens), në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai nuk paraqiti ndonjë informatë substanciale rreth rasteve të PKDNJ-së (shih *Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë* të 3 gushtit të vitit 2012, S/2012/603 në § 39). Kjo ishte para mendimit të parë të publikuar të PKDNJ-së për një rën nga ankesat e pranuar për zhdukjet, rrëmbimet dhe vrasjet, S.C. në dhjetor të vitit 2012. Shërbimi i Lajmeve në gjuhën serbe *Lajmet (Vesti)* diskutoi këtë mungesë të raportimit zyrtar të OKB-së për PKDNJ-në në publikimin e vet të lajmeve ‘online’ të 3 marsit të vitit 2014, “*Od Srbije ni glasa Protesta*” (“*From Serbia, There is No Voice of Protest*”), në të cilin thuhet “As një fjalë. Nuk është përmendur kurrë në raportet tremujore të UNMIK-ut për Këshillin e Sigurimit të OKB-së se PKDNJ, si organ i veçantë i UNMIK-ut, madje fare ekziston. Në ato raporte po ashtu nuk është përmendur kurrë ndonjëri nga më shumë se 100 mendimet e dhëna nga Paneli, në të cilat ai konstatoi se UNMIK-u kishte kryer shkelje serioze të të drejtave të njeriut” (Përkthimi në gjuhën angleze).

e Kombeve të Bashkuara të ndërmarrin ndonjë aktivitet të dobishëm në interes të ankuesve para se të përfundojë mandati i PKDNJ-së.

9. Përfundime

80. Paneli shpenzoi kohë të konsiderueshme në vitin 2014 duke shqyrtuar rastet dhe dhënë mendime për ankesat në lidhje me PZHV-të. Me pak përjashtime, në pothuaj të gjitha mendimet, Paneli konstatoi se UNMIK-u kishte bërë shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, duke dështuar të kryejë hetim adekuat dhe efektiv për zhdukjen apo rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmve të ngushtë të ankuesve. Pasi Paneli konstatoi se në shumë raste kishte të meta të ngjashme, në vitin 2014 Paneli e paraqiti në të dhëna për herë të parë se ai kishte konsideruar se dështimet e kryera nga UNMIK-u ishin sistemore (shih § 50 më lart).
81. Në shumë nga mendimet për PZHV-të, Paneli konstatoi se UNMIK-u po ashtu bëri shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, Paneli konstatoi se qëndrimi i UNMIK-ut ndaj ankuesve dhe familjeve të tyre lidhur me hetimet për zhdukjen, rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmve të tyre kontribuoi që ankuesit dhe familjet e tyre të përjetojnë shqetësim të rëndë në kundërshtim me të drejtën për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues.
82. Në përgjithësi, në vitin 2014, me mbylljen e 97 rasteve tjera, Paneli vazhdoi të bëjë një proces drejt përfundimit të të gjitha rasteve në listën e tij. Në fund të vitit 2014, kishte 88 raste në pritje të një mendimi mbi bazueshmërinë. Në mesin e tyre ka disa raste kryesore për të cilat Paneli pret të japë mendime në muajt në vijim (shih §§ 37-40 më lart). Në fakt, Paneli parashih ta përfundojë punën e vet në vitin 2015 duke përfunduar të gjitha rastet e veta të mbetura.
83. Pasi Paneli është afër përfundimit të punës së vet, është madje edhe më e rëndësishme që UNMIK-u të shfrytëzojë këtë mundësi që të zbatojë rekomandimet e Panelit para se të përfundojë mandati i PKDNJ-së dhe t'u ofrojë dëmshpërblim në para ankuesve të drejtat e të cilëve janë shkelur. Në këtë kuptim, Paneli thekson se në vitin 2014 UNMIK-u është përfshirë më shumë në proces duke bërë përpjekje të publikojë më shumë përgjigje në mendimet e Panelit (shih § 70 më lart). Megjithatë, Paneli e ka shqetësim serioz dështimin e UNMIK-ut deri më tani që t'u ofrojë ndonjë kompensim apo përfitim praktik ankuesve. Me qëllim të ofrimit të ca masave për ndihmë këtyre personave që tanimë kanë humbur aq shumë, dhe për t'i dhënë kuptim punës së Panelit si një organ që kishte për qëllim ofrimin e përgjegjësisë së UNMIK-ut për të drejtat e njeriut, Paneli, siç ka rekomanduar tanimë, kërkon nga UNMIK-u dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara të gjejnë ndonjë metodë për t'i kompensuar viktimat për shkeljen e të drejtave të tyre të njeriut.

10. Shtojcat:

Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi *themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut* e 23 marsit të vitit 2006

Shtojca B: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2009/1, *Implementimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut* e 17 tetorit të vitit 2009

Shtojca C: Tabela statistikore e PKDNJ-së

Shtojca D: Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së të marra në vitin 2014

Shtojca E: Ankesat e pranuar nga PKDNJ sipas vitit

Shtojca F: Rastet e mbyllura të PKDNJ-së (Të papranueshme, apo mendime mbi bazueshmërinë) sipas vitit

Shtojca G: Shkurtesat dhe akronimet

Shtojca A

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2006/12
23 mars 2006

RREGULLORE NR. 2006/12**MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriutNeni 1Themelimi i Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshilldhënës)

1.2 Paneli këshilldhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njëerën apo në më shumë instrumentet vijuese:

(a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;

b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollat e saj;

(c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollat e saj;

(d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;

(e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;

(f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;

(g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe

(h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshillëdhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshillëdhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshillëdhënëse.

Neni 2

Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshillëdhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3

Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshillëdhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshillëdhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshillëdhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshillëdhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 4 Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshillëdhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshillëdhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshillëdhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5 Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshillëdhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar¹⁴. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6 Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshillëdhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në

¹⁴Qëndrimi në detyrë i anëtarëve të Panelit është zvogëluar në një vit, me përtëritje, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2007/3 të 12 janarit të vitit 2007.

Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

Neni 7

Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshillëdhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshillëdhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t’ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshillëdhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8

Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshillëdhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9

Sekretariati

Panelit këshillëdhënës ka sekretariatit me orar të plotë.

KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 10

Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

10.1 Ankesat i parashtrohen Panelit këshillëdhënës në formë të shkruar.

10.2 Ankesa mund të parashtrohet nga ankuesi ose në emër të tij nga anëtari ifamiljes, nga organizata joqeveritare ose nga sindikata.

10.3 Në mungesë të parashtrimit të ankesës sipas nenit 10.2, Paneli këshilldhënës mund të emërojë një person të përshtatshëm përfaqësues sipas detyrës zyrtare për të parashtruar ankesën dhe për të vepruar në emër të viktimës ose viktimave të dyshuar në procedurën e përcaktuar në këtë kapitull nëse Paneli këshilldhënës ka informacionetë besueshme se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut.

10.4 Me kërkesën e përfaqësuesit të caktuar sipas detyrës zyrtare, Paneli këshilldhënës mund të përfundojë procedurën sipas nenit 10.3 nëse viktimat ose viktimat e dyshuara nuk dëshirojnë që të vazhdojë procedura ose nëse vazhdimi i procedurës nuk është me interes publik për ndonjë person tjetër.

10.5 Për parashtrimin e ankesës nuk parashihet kurrfarë pagese.

Neni 11

Parashtrësit me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshilldhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshilldhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigja e tillë i jepet Panelit këshilldhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtrësitë tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtrësitë janë në interes të drejtësisë.

Neni 12

Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13

Pjesëmarrja e një *Amicus Curiae* dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshilldhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një *amicus curiae* që të parashtrorë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrorjë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtrësas me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14
Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshillëdhënës mban seanca verbale.

Neni 15
Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshillëdhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshillëdhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të veçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16
Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës

16.1 Seancat e Panelit këshillëdhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshillëdhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vihen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17
Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës

17.1 Paneli këshillëdhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshillëdhënës i parashtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshillëdhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

Neni 18
Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshillëdhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i japë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshillëdhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjerë dhe qasjes në to.

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi më 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca B**UNITED NATIONS**

United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1

17 tetor 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1
Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklarata duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli

Këshillëdhënës mund t'ju parashtrijë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2 Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Komentet mbi bazueshmërinë e një pretendimi për shkelje të të drejtave të njeriut duhet dorëzuar vetëm pasi Paneli Këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin dhe vendosur për pranueshmërinë e ankesës së tillë. Nëse çështjet e pranueshmërisë së një ankese adresohen në çfarëdo kohe pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë marrë një vendim mbi pranueshmërinë e ankesës dhe filluar shqyrtimet e veta të bazueshmërisë, Paneli Këshillëdhënës do të suspendojë shqyrtimet e veta mbi bazueshmërinë deri në njëkohë që pranueshmëria e ankesës të rivlerësohet plotësisht dhe vendoset përsëri.

2.4 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3 Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundur Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4

Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5

Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca C:

Numri i lëndëve, komunikatave & vendimeve të HRAP-it (prej 31 dhjetor 2014)

Numri i lëndëve	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej	
Të pranuar	3	12	69	353	90 ¹⁵	n/a	n/a	n/a	n/a	527	
Të mbyllura	0	0	18	11	35 ¹⁶	98	95	85	97	439	
Në pritje të zgjidhjes	3	15	66	408	463	365	270	185	88	88	
Vendimet: Lloji	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej	
Gjithsej	0	0	32	26	84	213	270	90	103	818	
Vendimet për pranueshmëri	0	0	28	22	56	164	238	10	3	521	
Vendimet për pranueshmëri të pjesshme	0	0	2	0	1	0	0	-	-	3	
Të hequr nga lista	0	0	0	3	5	2	6	-	-	16	
Mendimet për bazueshmëri	0	0	1	0	22	46	23	79	96	267	
Mendime për bazueshmëri të pjesshme	0	0	0	1	0	0	0	-	-	1	
Kërkesat për rishqyrtim dhe Rihapje	0	0	1	0	0	1	3	2	4	11	
Vendimet: Gjetjet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Gjithsej	
Vendimet	Të pranueshme	0	0	11	2	16	63	112	2	-	206
	Pjesërisht të pranueshme	0	0	2	9	25	51	60	2	2	151 ¹⁷
	Të papranueshme	0	0	17	8	10	50	66	6	1	158
Mendimet: Shkelje	0	0	1	0	21	45	21	76	88	252	
Mendimet: Nuk ka shkelje	0	0	0	1	1	1	2	3	8	16 ¹⁸	
Kërkesat për rishqyrtim:	E Refuzuar	0	0	1	0	0	1	1	2	4	9
	E Pranuar	0	0	0	0	0	0	2	-	-	2

¹⁵ Duke u udhëzuar nga paneli rasti nr. 25/10 është ndarë në dy raste (rasti I ri nr.90/10)

¹⁶ Dy raste (nr.04/07 dhe 26/08) shpallen të papranueshme në 2010, janë rihapur nga Paneli më 2012.

¹⁷ Tre nga rastet janë vendime "pjesërisht të pranueshme".

¹⁸ Një nga vendimet është mendim i pjesërishtëm mbi bazueshmëri.

Shtojca D:**Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së të marra në vitin 2014****Vendimet pjesërisht të pranueshme: 2 (2)**

1. MILLADINOVIQ, Nebojsa, 331/09 –vendimi i 14 marsit të vitit 2013
2. KRASNIQI, Tomë, 08/10 –vendimi i 6 qershorit të vitit 2013

Vendimi mbi kërkesën për të rihapur procedurat: 4 (4)

1. JUGOBANKA I, 57/10 – vendimi i 12 shkurtit të vitit 2014
2. JUGOBANKA II, 58/10 – vendimi i 12 shkurtit të vitit 2014
3. R. A., 41/09 – vendimi i 13 marsit të vitit 2014
4. RISTIQ, Nevenka, 319/09 - vendimi i 23 tetorit të vitit 2014

Vendimet e papranueshme: 1 (1)

1. M. M. dhe M. V., 352/09 – vendimi i 29 majit të vitit 2014

Mendimet: Shkelje 53 (88)


1. MARKOVIQ, Aleksandër dhe MARKOVIQ, Lubinka, 91/09 dhe 338/09 – mendimi i 23 janarit të vitit 2014
2. VUJAÇIQ, Ivan, 118/09 – mendimi i 23 janarit të vitit 2014
3. VITOSHEVIQ Tatjana, MAJMAREVIQ Veska dhe MAJMAREVIQ Natasha, 139/09, 218/09 dhe 325/09 – mendimi i 23 janarit të vitit 2014
4. ANJELLKOVIQ, Lluka, 277/09 – mendimi i 23 janarit të vitit 2014
5. GUGA, Fillim, 47/08 – mendimi i 24 janarit të vitit 2014
6. ÇELIQ, Kenan dhe FAZLIJA, Enver, 51/09 dhe 53/09 – mendimi i 14 shkurtit të vitit 2014
7. STANOJKOVIQ, Danica dhe STOJKOVIQ, Milosav, 105/09 dhe 106/09 – mendimi i 14 shkurtit të vitit 2014
8. KNEZHEVIQ, Goran, 141/09 – mendimi i 14 shkurtit të vitit 2014
9. MILENKOVIQ, Millko 127/09 – mendimi i 13 marsit të vitit 2014
10. PEJÇINOVIQ, Millorad, 89/09 – mendimi i 13 marsit të vitit 2014
11. SHABIQ, Zvonko, 137/09 – mendimi i 13 marsit të vitit 2014
12. MITIQ, Serbolub, MITIQ, Sllavi, GJEKIQ, Smiljana, MARKOVIQ, Spasena, MARKOVIQ, Todor, JOVANOVIQ, Stanomir dhe JOVANOVIQ, Marija, 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09, 113/09, 162/09, 300/09 dhe 301/09 – mendimi i 14 marsit të vitit 2014
13. S. M., 110/09 – mendimi i 12 prillit të vitit 2014
14. P. R. 120/09 dhe 121/09 – mendimi i 14 prillit të vitit 2014
15. PETKOVIQ, Nebojsa, 125/09 dhe 126/09 – mendimi i 14 prillit të vitit 2014

16. KORIQANIN, Sonja, 167/09, 174/09 dhe 175/09 – mendimi i 14 prillit të vitit 2014
17. KLAIQ, Nedelka, 80/09 – mendimi i 29 majit të vitit 2014
18. JOVANOVIQ, Kata, 84/09 – mendimi i 29 majit të vitit 2014
19. RADOVANOVIQ, Biljana, 154/09, 155/09 – mendimi i 29 majit të vitit 2014
20. MILLANOVIQ, Zllatana, 339/09 – mendimi i 29 majit të vitit 2014
21. RISTIQ, Nevenka, 319/09 – mendimi i 30 majit të vitit 2014
22. MARKOVIQ, Spasena, 349/09 – mendimi i 25 qershorit të vitit 2014
23. MILLADINOVIQ, Nebojsa, 331/09 – mendimi i 25 qershorit të vitit 2014
24. MLLADENOVIQ, Milica, 99/09 – mendimi i 26 qershorit të vitit 2014
25. MARKOVIQ, Radmilla, 214/09 – mendimi i 26 qershorit të vitit 2014
26. V. L., GJ. M. dhe S. D., 291/09, 292/09 dhe 296/09 – mendimi i 26 qershorit të vitit 2014
27. IBRAJ, Muharem, 14/09, 15/09, 18/09, 19/09, 20/09 dhe 21/09 – mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
28. ÇUNGUROVIQ, Zhivka, 131/09 – mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
29. ZOGOVIQ, Sllavica, 152/09 – mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
30. MLLADENOVIQ, Nenad, 171/09 – mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
31. SHÇEKIQ, Radojka, 212/09- mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
32. SHLIVIQ-ÇERANIQ, Liljana, 237/09 dhe 238/09 – mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
33. RADISAVLEVIQ, Radivoje, 156/09 – mendimi i 17 shtatorit të vitit 2014
34. CVIJANOVIQ, Anka, 170/09 – mendimi i 17 shtatorit të vitit 2014
35. MILENKOVIQ, Bora, 176/09 – mendimi i 17 shtatorit të vitit 2014
36. PETKOVIQ, Sllobodan, 133/09 – mendimi i 18 shtatorit të vitit 2014
37. TOMIQ, Radmilla, 160/09 – mendimi i 22 shtatorit të vitit 2014
38. ANTIQ-ZHIVKOVIQ, Dobrilla, 147/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
39. PATRNOGIQ, Verica, 252/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
40. RADOVANOVIQ, Bosiljka, 177/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
41. ANDREJEVIQ, Millorad, 282/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
42. BUDIMIR, Olivera, 219/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
43. BISHEVAC, Angelina, 223/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
44. JANKOVIQ, Cica, 249/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
45. BULLATOVIQ, Vuksan, 166/09 – mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014
46. ARSIQ, Radmilla, 38/10 – mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014
47. MILLOSAVLEVIQ, Gavrillo, 163/09 – mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2014
48. JOVANOVIQ, Vinogorka, 222/09 – mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2014
49. VUJAÇIQ, Draginja, 226/09 – mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014
50. BIOÇANIN, Zllata, 229/09 – mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014
51. SHMIGIQ, Bogolub, 264/09 dhe 265/09 – mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014
52. STEVANOVIQ, Marija, 289/09 – mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014
53. NIKOLIQ, Lela, KABASH, Rosanda dhe PETROVIQ, Millan, 72/09, 73/09, 74/09, 75/09, 76/09, 78/09, 95/09 dhe 96/09 – mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014


Mendimet: Asnjë shkelje 3 (8)

1. MARKOVIQ, Marko, 142/09 – mendimi i 12 prillit të vitit 2014
2. REMISHTAR, Sllagjana, 245/09 – mendimi i 17 tetorit të vitit 2014
3. MITROVIQ, Liljana, KRSTIQ, Danijella, KRSTIQ, Sllobodanka, SIMONOVIQ, Snezhana dhe SHULJINIQ, Jeremija, 144/09, 158/09, 209/09, 210/09, 258/09 dhe 276/09- mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014

Shtojca E



Shtojca F



Shtojca G

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

- AI** – Amnesty International (Amnestia Ndërkombëtare)
- DOJ – DD** – Departamenti i Drejtësisë
- DPPO - PPQ**- Prokuroria Publike e Qarkut
- ECHR - KEDNJ**- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- ECtHR - GJEDNJ**- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- EU – BE** – Bashkimi Evropian
- EULEX** – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
- HLC- QDH**-Qendra për të Drejtën Humanitare
- HRAP-PKDNJ**-Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
- HRC – KDNJ** – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
- IACtHR – GJNADNJ**- Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
- ICESCR –KNDESK**- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- ICMP – KNPZH** – Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur
- ICRC – KNKK**- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
- ICTY – TNPJ**-Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi
- KFOR** – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
- KLA – UÇK** - Ushtria Çlirimtare e Kosovës
- KTA-AKM**- Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
- LCP-LPP**-Ligji Jugosllav për Procedurat Penale
- MMP – PZHV** – Person i Zhdukur/i Vrarë
- RTK**- Radio Televizioni i Kosovës
- SRSG – PSSP**- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
- UN – KB**- Kombet e Bashkuara
- UNGA-APOKB**-Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
- UNMIK** – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë